

SUBJEKTI		TERRITORI KU ZI		
EMRI I SUBJEKTTIT ZHVILLUES	EMRI I HEC-it	ADRESA ADMINISTRATIVE		
		QARKU	BASHKIA	BASENI
"Eurobiznes" sh.p.k.	Lusen 1,2,3	Kukës	Kukës	Drin
"Ageta"	Borie Lure	Kukës	Kukës	Drin
"Trojet Energji"	Trojet	Kukës	Kukës	Drin
"Invictus"	Bregu Leres	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Vjosë
"Afrimi K"	Thanza	Kukës	Kukës	Drin
"Fatjon"dhe "Rruga Ura Afaltim nr.2 Elbasan"	Terfoje	Kukës	Kukës	Drin
"CR Poëer"shpk	Tezalla 1,2	Dibër	Bulqizë	Drin
"Gerti"shpk	Jetoni	Dibër	Dibër	Drin
"Gerti"shpk	Miresh	Dibër	Dibër	Drin
"Laster Energy"	Kronz	Dibër	Dibër	Drin
"Erim"shpk	Shytaj	Dibër	Bulqizë	Drin
"ABV Konstruksion" shpk	Kaparjel	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Vjosë
"Lajthiza Invest" shpk	Qami 1	Kukës	Kukës	Drin
"Eraldi & PSM"shpk	Bugjoni	Shkodër	Pukë	Drin
"Brecani R.O.S.P"shpk	Drita	Kukës	Tropojë	Drin
"L & G Energy " shpk	Guri I Kuq: 1/1, 1/2	Berat	Skrapar	Vjose
"Clean Energy AL" sh.p.k	Vajkal Hec 1, 2, 3	Diber	Bulqizë	Drin
"MUHURR ENERGY"shpk	Runja	Diber	Peshkopi	Drin
"DUKA T2" sh.p.k.	Tuçep 2	Diber	Bulqizë	Drin
"HEC Lashkiza" shpk	Lashkiza 1, 2, 3	Diber	Peshkopi	Drin
"hydro Seta"shpk	Seta 1, 2, 3, 4	Diber	Peshkopi	Drin
"TEODORI 2003" shpk	Ternova, Zall Bulqiza	Diber	Bulqizë	Drin
"KISI-BIO-ENERGJI" sh.p.k.	Kacni	Diber	Peshkopi	Drin
"Erdat Lura" sh.p.k	Lura 1, 2, 3	Diber	Peshkopi	Drin
"Pure Energy Stebleva" sh.p.k	Stebleve	Elbasan	Librazhd	Drin
"Kendrevic Energy"shpk	Driza 1	Gjirokastrë	Tepelen	Vjose
"Gusmar" shpk	Meshanik, Guve	Gjirokastrë	Tepelen	Vjose
"MESOPOTAM ENERGY"shpk	Driza	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Vjose
"LAJTHIA & KOLESIAN ENERGY"shpk	Lajthi, kolosjan, domaj	Kukes	Kukes	Drin
"Hec Viliq 1&2"	Viliq 1, 2	Kukes	Tropojë	Drin
Tplani Hec shpk	Valbone	Kukes	Tropojë	Drin
Thaci sh.p.k	Domaj	Kukes	Has	Drin
"Dragobia Energy" Shpk	Dragobia, Ceremi	Kukes	Tropojë	Drin
"S.P.E GJADER" shpk	Gjader	Shkodër	Lezhe	Drin
"Asses Energy Albania"shpk	Kiri 1, Kiri 2	Shkodër	Shkodër	Drin
"Novo Sapac Energie" shpk	Iballe 1, 2, Sapac 1, 2, Berishe, Liqeni	Shkodër	Puke	Drin
"VALBONA ENERGY ALBANIA"shpk	Kaskada Valbones	Shkodër Kukes		Drin
"3POWER SHALA"shpk	Hece mbi lumin Shale	Shkodër		Drin

Hec Vernik Shpk	<b>Vernik nr. 1, 2, 3, 4</b>	Vlore	Vlore	Vjose
Kovlu Energji sh.p.k	<b>Poçem</b>	Fier	Mallakaster	Vjose
Shushica Hydropoëer shpk	<b>Kaskada e Hec-eve mbi lumin Shushice</b>	Vlore		Vjose
"Reka Energy" shpk	<b>Meshteken (Zaje, Turaj, Xhaferraj, Kollovoz, Novoseje, Meshteken)</b>	Kukes	Kukes	Drin
Domi Tec sh.p.k	<b>Plepi</b>	Diber		Drin
AYEN - ALB sha	<b>Kalivaç</b>	gjirokaster	Tepelenë	Vjose
KALISI HYDROPOËER	<b>Veleshica 1, 2</b>	Diber	Diber	Drin
"Ferar Energy" sh.p.k	<b>Bence, Tepelene</b>	Gjirokaster	Tepelen	Vjose
Skatine hec shpk	<b>Skatina</b>	Kukes	Has	Drin
"Tucep" sh.p.k	<b>Tucep</b>	Diber	Bulqizë	Drin
Alban Grën Energy sh.p.k	<b>Smokthina</b>	Vlore	Vlore	Vjose
Balkan Grën Energy sh.p.k	<b>22 Hec-e</b>	Hec-e Vendore		
"ERMA M.P" sh.p.k	<b>Çarshove</b>	Gjirokaster	Permet	Vjose
"GJO-SPA POWER" sh.p.k	<b>Lapaj</b>	Kukes	Kukes	Drin
"Lengarica & Energy" Shpk	<b>Lengarica</b>	Gjirokaster	Permet	Vjose
"Selishte" Shpk	<b>Selishte</b>	Diber	Peshkopi	Drin
"ENERGJI ASHTA" sh.p.k	<b>Ashta 1, 2</b>	Shkoder	Vau I Dejes	Drin
"M.T.C.Energy" Shpk	<b>Radove</b>	Korce	Kolonje	Vjose
"Peshku Picar 1" Shpk	<b>Picar 1</b>	Gjirokaster	Gjirokaster	Vjose
"HIDROALBANIA ENERGJI" sh.p.k	<b>Borje Oreshke Cernaleve 1, 2</b>	Kukes	Kukes	Drin
EURON ENERGY GROUP: Energal shpk; Alb-energy shpk;	<b>Bele 1 &amp; Topojan 2; Orgjost i Ri; Bele 2 &amp; Topojan 1;</b>	Kukes	Kukes	Drin
"Erald 2-Energy" shpk LEADDENERGY shpk	<b>Shemri; Mgull;</b>	Kukes	Kukes	Drin
"SA-GLE KOMPANI" sh.p.k.	<b>Hec-et ne prr.Trebisht</b>	Diber	Peshkopi	Drin
"Perparimi SK" sh.p.k.	<b>Shtika 1, 2, 3, 4</b>	Gjirokaster	Permet	Vjose
"Idro Energjia Pulita" shpk	<b>Gostivisht, Langarica 3, Ura e Dashit</b>	Gjirokaster	Permet	Vjose
Wenerg sha	<b>Kaskada e hidrocentraleve ne lumin Dardhe</b>	Shkoder	Puke	Drin
"Energy Plus" shpk	<b>Pobreg</b>	Kukes	Kukes	Drin
"Lu&Co Eco energy 2011"	<b>Ostreni I vogel</b>	Diber	Bulqizë	Drin
"Truen" shpk	<b>Truen</b>	Shkoder	Puke	Drin
"Gjurr Rec" shpk	<b>Malla</b>	Diber	Peshkopi	Drin
"FATLUMI" sh.p.k.	<b>Perrollaj</b>	Kukes	Kukes	Drin
"Diteko" Shpk	<b>Kaskada Zalli Okshtunit</b>	Diber	Bulqizë	Drin
C & S Construction Energy	<b>Suha 2</b>	Gjirokaster	Gjirokaster	Vjose
"Shala Energy" shpk	<b>Kaskada e hidrocentraleve ne lumin Shale</b>	Shkoder	Shkoder	Drin
"RAJAN ENERGY" shpk	<b>Kaskada Rajan</b>	Korce	Kolonje	Vjose
VELESHICA ENERGY shpk	<b>Kaskada e Veleshices:</b>	Diber	Peshkopi	Drin

Bashkimi shoqerive Anglikan Energy LMT, Montagues LLp e Alba Ndertim	<b>Suha 1</b>	Gjirokaster	Gjirokaster	Vjose
Telemenia Curraj shpk	<b>Lumin Curraj</b>	Kukes	Tropoojë	Drin
"VILDRI" shpk	<b>Myhejan Hec 1, 2, 3</b>	Kukes	Tropoojë	Drin
Melova Arez	<b>Arrez 1, 2, 3, 4</b>	Gjirokaster	Memaliaj	Vjose
HIDROBEGAJ	<b>Begaj</b>	Kukes	Tropoojë	Drin

HVILLOHET	FORMA E KONTRATES
ADRESA UJORE	
LUMI/ PERROI	
Përroi i Mullirit dhe i Vallnijeve	Mbeshtetur ne VKM 822/2015
perrenjve te Kurores se Lures.	Mbeshtetur ne VKM 822/2016
përoit Lushajve (Fshatit) dege e lumit Bushtrice	Mbeshtetur ne VKM 822/2017
Përroi Mezhgoranit	Mbeshtetur ne VKM 822/2018
përroi Kalimashit	Mbeshtetur ne VKM 822/2019
Perroi i Fshatit dhe p. i Madh	Mbeshtetur ne VKM 822/2020
Perroi i Thatë	Mbeshtetur ne VKM 822/2021
përroi Tuçepit	Mbeshtetur ne VKM 822/2022
përroi Mireshit	Mbeshtetur ne VKM 822/2023
p.Shehut	Mbeshtetur ne VKM 822/2024
pr. Hetmi dhe Sheshi i Vogel	Mbeshtetur ne VKM 822/2025
rehabilitim HEC ekz	Mbeshtetur ne VKM 822/2026
pr. Srriqes, Satrave dhe Vales	Mbeshtetur ne VKM 822/2027
Bugjonit	Mbeshtetur ne VKM 822/2028
Lumi Gashit	Mbeshtetur ne VKM 822/2029
Prr. Gostivisht, Kollovesh	Kontrate Koncesioni
Zalli I bulqizes	Kontrate Koncesioni
Perroi I Murres	Kontrate Koncesioni
Tuçep	Kontrate Koncesioni
Vathit, Lashkizes, Shehut	Kontrate Koncesioni
lumi I setes	Kontrate Koncesioni
Drin	Kontrate Koncesioni
Peshk	Kontrate Koncesioni
Molla e Lures	Kontrate Koncesioni
Zalli I Stebleves	Kontrate Koncesioni
perroi i Ademit	Kontrate Koncesioni
pr. Lajthizë, Sharovë, Baxhi, i Madh, Miroxixës, Valëve, Kozicës, Zeqos, Poporaves dhe Kadenës	Kontrate Koncesioni
Perroi i Vrisit	Kontrate Koncesioni
perroi I Thate	Kontrate Koncesioni
Bytyc	Kontrate Koncesioni
lumi valbona	Kontrate Koncesioni
Burimi Domaj	Kontrate Koncesioni
lumi valbone	Kontrate Koncesioni
Lumi Drin	Kontrate Koncesioni
lumi kir, deget gjuraj, kashec, ragam, lepurushe	Kontrate Koncesioni
Drin	Kontrate Koncesioni
	Kontrate Koncesioni
lumi i shalës	Kontrate Koncesioni




Smokthine	Kontrate Koncesioni
lumi i vjoses	Kontrate Koncesioni
lumi shushice, Vlore	Kontrate Koncesioni
perroi I rekes dhe shishtavecit	Kontrate Koncesioni
perroi I Plepes	Kontrate Koncesioni
Lumi Vjosë	Kontrate Koncesioni
perroi I veleshices	Kontrate Koncesioni
Bences	Kontrate Koncesioni
perroi I Skatines	Kontrate Koncesioni
Drin	Kontrate Koncesioni
Vjose	Kontrate Koncesioni
Hec-e Vendore	Kontrate Koncesioni
Carshoves	Kontrate Koncesioni
Cajes	Kontrate Koncesioni
Lumi I lengarices	Kontrate Koncesioni
Prr. I Qaf Murres, prr. I Madhe	Kontrate Koncesioni
Drin	Kontrate Koncesioni
Carshoves	Kontrate Koncesioni
Prr. Gures	Kontrate Koncesioni
perroi I borjes	Kontrate Koncesioni
lumi luma, zapod	Kontrate Koncesioni
lumi I Leproit,	Kontrate Koncesioni
Perroi i Trebishtit	Kontrate Koncesioni
Shtikes	Kontrate Koncesioni
Lumi Gostivisht	Kontrate Koncesioni
Lumi I Dardhes	Kontrate Koncesioni
Lumi Luma	Kontrate Koncesioni
Ostreb	Kontrate Koncesioni
Truen	Kontrate Koncesioni
Molla e Lures	Kontrate Koncesioni
perroi I bexmilles, golaj, kukes	Kontrate Koncesioni
Zalli I Okshtunit	Kontrate Koncesioni
Suha	Kontrate Koncesioni
Shale	Kontrate Koncesioni
Lumi Langaricës, Dedovë, Peshtan	Kontrate Koncesioni
...	Kontrate Koncesioni
Drin	Kontrate Koncesioni

Suha	Kontrate Koncesioni
lumi curraj	Kontrate Koncesioni
perroi I tropojesh	Kontrate Koncesioni
perroi I arrezit	Kontrate Koncesioni
Lumi I Gashit, tropoje	Kontrate Koncesioni

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 1263 Rep.  
NR. 827 Kol.



KONTRATË KONCESIONI  
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT "KALIVAÇ"

Në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 3 muaji Qershor viti 2018 (dy mijë e tetëmbëdhjetë), para meje notarit Mustafë Kollonçiu, anëtar i dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë Kollonçiu Mustafë, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË e Republikës së Shqipërisë, e cila vepron në emër të Qeverisë së Shqipërisë, që më poshtë do të quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", përfaqësuar në bazë të autorizimit nr.2535/17 date 07.05.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, nga Z.Gentian Këri, Sekretar i Pergjithshëm, shtetas shqiptar, lindur më datë madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u sigurova nga leternjoftimi me numër (

DHE

SUBJEKTI PËR QËLLIME TË VEÇANTA, SHOQËRIA KONCESIONARE "AYEN - ALB" SH.A., që më poshtë do të quhet "KONCESIONARI", e themeluar nga operatori ekonomik i zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomik, shoqëritë "AYEN ENERJË" A.S. dhe "FUSHA" SH.P.K., në formën e një shoqërie anonime sipas ligjit Shqiptar, regjistruar më datë 09/11/2017, në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me NUIS L72321029P, me seli në adresën: Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. "Papa Gjon Pali i II-te", ABA Business Center, Kati 6, Zyra nr. 601, Tirane, Shqiperi, përfaqësuar nga Administratori Z. Fahrettin Amir ARMAN, shtetas turk, lindur në më datë madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga dokumenti i identifikimit pashaporte me nr. (së bashku "Palët" dhe secila veçmas "Pala")

Hyrje

Duke patur parasysh se:

**Qeveria e Shqipërisë:**

1. I ka dhënë një rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike nëpërmjet ndërtimit të hidrocentraleve të rinj apo rehabilitimit të hidrocentraleve ekzistues për përmirësimin e treguesve teknikë dhe ekonomikë të rrjetit elektrik kombëtar; me anë të investimeve të bazuara në koncesione/partneritet publik privat,
2. Konsideron ndërtimin e hidrocentraleve si një element të rëndësishëm të politikës së zhvillimit të sektorit të energjisë;
3. Është e angazhuar për krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë elektrike brenda vendit;
4. Mirëpret investitorët vendas ose të huaj në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;

5. Ka nisur procedurat e tenderimit për dhënien e një koncesioni për ndërtimin e hidrocentralit "Kalivaç" mbi lumin Vjosë, në qarkun e Gjirokastrës, shpallur nga Agjencia e Prokurimit Publik në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ (që më poshtë do të quhen "PROCEDURA PËRZGJEDHËSE") dhe në përfundim të Procedurës Përzgjedhëse konkurruese, ka vlerësuar dhe përzgjedhur bashkimin e operatorëve ekonomik, shoqëritë "AYEN ENERJI" A.S. dhe "FUSHA" SH.P.K. dhe "që më poshtë do të quhen "BASHKIMI I PËRKOHSHËM I OPERATORËVE EKONOMIKË", si ofertuesi më i suksesshëm për koncesionin objekt të kësaj Kontrate.

#### **Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë:**

1. Ka dorëzuar ofertën e tij dhe në përfundim të Procedurës Përzgjedhëse, është vlerësuar si ofertuesi më i suksesshëm;
2. Është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentralit përkatës në pellgun ujëmbledhës të lumit Vjosë me qëllim prodhimin e energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të zonës;
3. Zotëron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiarë, për të realizuar projektin e miratuar sipas objektivit të kësaj Kontrate Koncesioni;
4. Zotëron aftësitë drejtuese, financiare dhe teknike të kërkuara si dhe aftësitë për të plotësuar këtë iniciativë në përputhje me standardet ndërkombëtare;
5. Ka themeluar subjektin për qëllime të veçanta, për zbatimin e objektivit të kësaj Kontrate Koncesioni.

Atëherë, Palët lidhin këtë Kontratë Koncesioni (përcaktuar si vijon) bazuar në Ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat", i ndryshuar, duke rënë dakord për sa më poshtë:

### **KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1 Përkufizimet, Interpretimi**

##### **1.1 Përkufizimet**

Kudo që në këtë Kontratë Koncesioni përdoren termat e mëposhtme, ato do të kenë kuptimet përkatëse si vijon. Termat e tjerë që mund të përkufizohen diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni do të kenë kuptimet që parashikohen në nenet apo anekset përkatëse të kësaj Kontrate Koncesioni.

- 1.1.1 **Aneks:** është çdo deklaratë, vërtetim, autorizim, vendim, urdhër ose dokument tjetër i nënshkruar nga Palët dhe që bashkëlidhen kësaj Kontrate Koncesioni, si pjesë përbërëse e saj.
- 1.1.2 **Asetet Ekzistuese** janë të gjitha pronat e paluajtshme dhe të luajtshme, asetet, pajisjet, makineritë dhe materialet ekzistuese të Sheshit të përfshira në dokumentet e tenderit, për të cilat Koncesionari ka paraqitur ofertën financiare përkatëse, të cilat do të identifikohen, verifikohen, vlerësohen, transferohen dhe dorëzohen sipas dispozitave të Nenit 5 - Transferimi dhe dorëzimi i Aseteve Ekzistuese, nëpërmjet një

Procesverballi Dorëzimi të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do i bashkëlidhet si Aneks kësaj Kontrate dhe do të përbëjë pjesë integrale të saj.

- 1.1.3 **Autoriteti Kontraktues:** është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë elektrike të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, aktualisht Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- 1.1.4 **Autoritet Publik:** do të thotë (i) Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ose çdo ministri, ose nënndarje politike a ushtarake e saj (ii) çdo autoritet, agjenci, organ, ent tjetër shtetëror, nën kontrollin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Republikës së Shqipërisë (iii) çdo njësi e pushtetit vendor, autoritet, agjenci, organ, ent ose nënndarje e saj (iv) gjykatat, që ushtrojnë juridiksion sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë mbi Koncesionarin, në çdo rast brenda Republikës së Shqipërisë. Për të shmangur çdo keqinterpretim 'kontroll i tërthortë' përfshin vëzhgimin ose mbikëqyrjen e duhur të ERE, KESH, OST, OSHEE ose cdo ent tjetër përgjegjës për energjinë elektrike nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- 1.1.5 **Bashkimi i Përkohshëm i Operatorëve Ekonomikë:** do të thotë bashkërisht shoqëritë "AYEN ENERJI" A.S. dhe "FUSHA" SH.P.K. të cilët kanë krijuar shoqërinë SPV, Shoqëria Koncesionare "AYEN – ALB" SH.A., sipas kërkesave të Ligjit për Koncesionet, i ndryshuar dhe me kërkesë të Autoritetit Kontraktues.
- 1.1.6 **Certifikata e Pranimit të Veprës:** do të thotë dokumenti i lëshuar nga Autoriteti Kontraktues për Hidrocentralin, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 13.
- 1.1.7 **Data e Hyrjes në Fuqi:** është data e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 1.1.8 **Data e Mbarimit:** është data e përvjetorit të 35-të të Datës së Hyrjes në Fuqi.
- 1.1.9 **Data e Zgjidhjes:** do të thotë data e zgjidhjes paraprake të kësaj Kontrate Koncesioni, në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas Nenit 15.
- 1.1.10 **Ditë Pune:** është çdo ditë e javës përveç të ditës së Shtunë, të Dielë dhe ditëve të tjera të festave zyrtare në Republikën e Shqipërisë.
- 1.1.11 **Ekspert i pavarur** do të thotë eksperti, i cili nuk është i punësuar i Koncesionarit ose Autoritetit Kontraktor, që ka njohuri të thella në fushën teknike-ekonomike dhe ligjore, i cili zgjidh mosmarrëveshje për çështje të natyrës teknike-ekonomike (përveç çështjeve që lidhen me interpretimet juridike të kontratës), me kompetencat e përcaktuara në nenin 30 të kësaj kontrate.
- 1.1.12 **Enti Rregullator i Energjisë** është Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë (ERE) ose ndonjë rregullator ose departament tjetër rregullator i energjisë elektrike, ose Autoritet Publik i Republikës së Shqipërisë i krijuar mbi bazën e Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".
- 1.1.13 **E Drejta për Kalim:** do të thotë e drejta për të kaluar mbi dhe nën Shesh, dhe në çdo pjesë të tij, si dhe për të hyrë dhe për të dalë në të, pa pengesa, vonesa, shqetësime të rendit publik apo ndërhyrje të parregullt nga ndonjë palë e tretë me qëllimin e zbatimit të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.14 **Gëzim i Qetë:** do të thotë e drejta ekskluzive për të përdorur dhe gëzuar Hidrocentralin Sheshin dhe Asetet Ekzistuese, të Drejtën për Kalim dhe akses gjatë Kohëzgjatjes së Koncesionit, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni, pa ndërhyrje të pajustificuara nga Autoriteti Kontraktues, nga ndonjë Autoritet Publik ose nga ndonjë subjekt privat, përveçse në rastet kur përcaktohet ndryshe në këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.15 **Hidrocentrali:** është centrali i prodhimit të energjisë elektrike i ndodhur në Kalivaç, në lumin Vjosë, në qarkun e Gjirokastrës, së bashku me tërësinë e strukturave, aseteve, punimeve, instalimeve dhe makinerive apo pajisjeve të instaluara për prodhimin e energjisë elektrike, duke përfshirë por pa u kufizuar në; turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse, transformatorët, nënstacionin dhe linjën e transmetimit deri në Pikën e Lidhjes së energjisë në rrjet, si dhe Asetet Ekzistuese.



- 1.1.16 **Infrastrukturë Zëvendësuese** janë rrugët, urat dhe çdo lloj tjetër infrastrukture që do të ndërtohet për të zëvendësuar ose mundësuar atë infrastrukturë që do të jetë nën ujë ose që do të bëhet e papërdorshme për shkak të funksionimit të Hidrocentralit.
- 1.1.17 **Instrument Financiar:** do të thotë çdo marrëveshje huaje, kredie, marrëveshje siguroese ose çdo instrument tjetër i përdorur nga Koncesionari në lidhje me financimin e Objektivit të Koncesionit, duke përfshirë çdo ndryshim, shtesë, rinovim apo zëvendësim të secilit prej këtyre instrumenteve.
- 1.1.18 **Investimi:** është vlera totale monetare sipas preventivit të punimeve që do të investohet nga Koncesionari, në formën e kapitalit apo të huave, që do të shërbejë për financimin e projektit, ndërtimin dhe pajisjen e Hidrocentralit me makineritë e nevojshme (një kopje e preventivit të punimeve bashkëlidhet si Aneksi 2).
- 1.1.19 **Konhëzgjatja e Koncesionit:** do të thotë afati i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.20 **Komisionimi:** është procedura e parashikuar sipas nenit 13 të kësaj Kontrate Koncesioni për marrjen e Certifikatës së Pranimit të Veprës, për Hidrocentralin.
- 1.1.21 **Kompensim** do të jetë vlera e përfituar nga Koncesionari në rastet e percaktuara në kete Kontrate Koncesioni. Rregullat e Kompensimit përcaktohen në Anekset 4, 4a, 4b, 4c dhe 4d të kësaj Kontrate.
- 1.1.22 **Koncesionari:** do të thotë subjekti për qëllime të veçanta, Shoqëria Koncesionare "AYEN – ALB" SH.A., themeluar nga bashkimi i operatorëve ekonomike i zgjedhur si ofertuesi me i suksesshëm, siç identifikohet në këtë Kontratë Koncesioni.
- 1.1.23 **Kontratrat:** janë të gjitha kontratat e nënshkruara nga Koncesionari me palet e treta, për realizimin e Punimeve shfrytëzimin, operimin e Hidrocentralit dhe/ose sigurimin e financimit.
- 1.1.24 **Kontrata e Koncesionit ose Kontrata:** është kjo kontratë, anekset dhe çdo dokument tjetër që përcaktohet si pjesë përbërëse dhe e pandarë e saj.
- 1.1.25 **Leje:** do të thotë çdo miratim, leje, licencë, autorizim ose certifikatë, ose akt tjetër i kërkuar, nxjerrja ose ripërtëritja e së cilës është në përgjegjësinë e një Autoriteti Publik dhe që kërkohet në lidhje me zbatimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Kontrate, zbatimin e projektit, ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentralit, shitjen e energjisë së prodhuar dhe riatdhesimin e përfitimeve ose pagesave të borxhit nga Koncesionari ose shoqëria koncesionare, duke përfshirë por pa u kufizuar në të gjitha lejet e nevojshme që lidhen me:
- a) Sheshet dhe Gëzimin e Qetë;
  - b) mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, duke përfshirë vlerësimin e ndikimit në mjedis;
  - c) të drejtat e përdorimit të ujit;
  - d) të drejtat për të përdorur Materialet e Nevojshme të Ndërtimit përfshirë materialet nga shtrati i lumit Vjosë;
  - e) të drejtat për të prerë dhe përdorur lëndën e drurit nga pyjet në Sheshe; dhe
  - f) të drejtat për të depozituar dhe ruajtur mbetjet dhe materialet e gërmuara, si tek Sheshet dhe kudo gjetkë, dhe për të trajtuar mbetjet ujore.
- 1.1.26 **Ligj:** është çdo ligj i zbatueshëm kombëtar ose vendor, akt nënligjor, urdhër, udhëzim, rregullore, qarkore, dekret, kod ose çdo rregull tjetër, apo leje, licencë, autorizim, miratim ose aprovim tjetër i enteve shtetërore të Republikës së Shqipërisë
- 1.1.27 **Ligji Për Koncesionet:** do të thotë legjislacioni shqiptar mbi koncesionet dhe partneritetin publik privat, aktualisht Ligji nr.125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat" i ndryshuar, siç mund të ndryshohet, shtohet apo zëvendësohet herë pas here.



1.1.28 **Materialet e Nevojshme të Ndërtimit** janë rëra, copëra betoni, gurë, shkëmbinj, zhavorr, inerte, lëndë druri, ujë dhe materiale të tjera ndërtimi që janë të nevojshme për ndërtimin e projektit, duke përfshirë materialet nga shtrati i lumit Vjosë.

1.1.29 **Mbyllje Financiare** është realizimi i kushteve për financimin e Projektit nga Koncesionari.

1.1.30 **Mospërmbushjet nga Autoriteti Kontraktues:** janë mospermbushjet nga Autoriteti Kontraktues, të detyrimeve ose garancive sipas kësaj Kontrate Koncesioni, që pengojnë, cenojnë, shkaktojnë një efekt thelbësisht negativ, bëjnë të pamundur ose vonojnë në mënyrë të pajustificuar, zbatimin e Objektivit të Koncesionit nga ana e Koncesionarit përtej afateve të kësaj Kontrate dhe/ose afateve ligjore dhe e bëjnë të pamundur;

- a) gëzimin nga Koncesionari të çdo të drejte dhe përfitimi sipas kësaj Kontrate;
  - b) përmbushjen nga Koncesionari të secilit prej detyrimeve të percaktuara në këtë Kontrate;
  - c) ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Hidrocentralit dhe prodhimin e energjise elektrike;
  - d) gëzimin nga çdo ortak i shoqërisë koncesionare të të drejtave dhe përfitimeve të cilat ai i gëzon për shkak të pjesëmarrjes në shoqërinë koncesionare;
- Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktues do të konsiderohet edhe mospërmbushja e detyrimeve të marra përsipër nga Autoriteti Kontraktues në lidhje me Nenin 5 – Transferimi dhe dorëzimi i Aseteve Ekzistuese, Nenin 6 - Të Drejtat Koncesionare, Nenin 8 - Detyrimet e Autoritetit Kontraktues dhe Nenin 10 – Zëvendësimi i infrastrukturës Ekzistuese që do të bëhet e papërdorshme.
- Mospërmbushjet nga Autoriteti Kontraktues, do të përbëjnë shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate me kusht që Koncesionari t'i ketë dhënë Autoriteti Kontraktues një njoftim paraprak shkeljeje në përputhje me dispozitat e korrigjimit të shkeljeve sipas Nenit 23 të kësaj Kontrate.

1.1.31 **Mospërmbushjet nga Koncesionari janë:**

- a. mospërmbushja nga Koncesionari e detyrimeve të kësaj Kontrate Koncesioni, që e cila ben te pamundur zbatimin e Objektivit të Koncesionit.
- b. disponimi i Hidrocentralit, apo pjesëve të tij, nga ana e Koncesionarit në kundërshtim me kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni;
- c. braktisja e Punimeve nga ana e Koncesionarit, për më shumë se 100 (njëqind) ditë të njëpasnjëshme;

Mospërmbushjet nga Koncesionari do të përbëjnë shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate me kusht që Autoritetit Kontraktues t'i ketë dhënë Koncesionarit një njoftim paraprak shkeljeje në përputhje me dispozitat e korrigjimit të shkeljeve sipas Nenit 23 të kësaj Kontrate.

1.1.32 **Ndryshim në Ligj** do të thotë nxjerrja, miratimi, dekretimi, hyrja në fuqi e një ligji të ri, ose akti tjetër detyrues në Shqipëri, ose shfuqizimi, amendimi, ndryshimi në zbatim ose ndryshimi pas datës së ofertës së Koncesionarit, i ndonjë ligji në Shqipëri.

1.1.33 **Ngjarje e Forcës Madhore:** do të thotë çdo ngjarje që ndodh pas datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate Koncesioni, cila është jashtë kontrollit të arsyeshëm, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të Palëve, që rezulton ose shkakton një pamundësi të Palës së Cenuar në përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate Koncesioni (me përjashtim të pagesës së parave), por vetëm nëse dhe në masën që:

- a. kjo rrethanë, pavarësisht ushtrimit të kujdesit të arsyeshëm, nuk mund të parandalohet ose nuk ishte e mundur të parandalohet, shmangej ose mënjanohet nga Pala e Cenuar;
- b. Pala e Cenuar mori ose ka marrë të gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative në mënyrë që të shmange



pasojën e këtij rasti në aftësinë e Palës së Cenuar për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate dhe për të zbutur pasojat e saj;

- c. ngjarja nuk është, ose nuk ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e shkeljes nga Pala e Cenuar të një prej detyrimeve të saj sipas kësaj Kontrate; dhe
- d. Pala e Cenuar t'i ketë dhënë njoftim Palës tjetër për këtë Rast të Forcës Madhore.

Ngjarjet e Forcës Madhore do të përfshijnë, sa vijon:

- i. akte lufte ose luftë civile konflikte të armatosura ose akte terrorizmi, akte rebelimi, kryengritje, trazira civile, çdo akt sabotimi, bllokadë, embargo;
- ii. ndotje nukleare, kimike ose biologjike;
- iii. tërmet, zjarr, shpërthim, rrufe, stuhi, shtrëngatë, cikloni, tajfuni, tornado, përmytje, thatësi, rrëshqitje toke, epidemi apo murtajë;

**Ngjarjet e Zgjidhjes:** do të thotë secila nga ngjarjet e mbetura të paplotësuara apo të pakorrigjuara si dhe çdo ngjarje tjetër, e cila, sipas kësaj Kontrate Koncesioni i jep të drejtë seciles Pale për të zgjidhur këtë Kontratë Koncesioni në përputhje me Nenin 15.

1.1.35 **NJTDAE** është Njësia e transferimit dhe dorëzimit të aseteve ekzistuese.

1.1.36 **Nisja e punimeve:** është data e nisjes së zbatimit të Punimeve të ndërtimit, sipas Nenit 12 të kësaj Kontrate Koncesioni.

1.1.37 **Objekti i Koncesionit:** do të thotë financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, shfrytëzimi, mirëmbajta e Hidrocentralit dhe transferimi i tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni.

1.1.38 **Operimi:** do të thotë tërësia e veprimeve të Koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike, në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni.

1.1.39 **Palë Financuese:** do të thotë çdo institucion financiar i licencuar si i tillë, që do të ndihmojë Koncesionarin në financimin e Objektivit të Koncesionit.

1.1.40 **Palë e Tretë:** është çdo palë e ndryshme nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari.

1.1.41 **Palë të Lidhura:** janë dy persona mes të cilëve ekziston, drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë, një marrëdhënie kontrolli, dhe/ose dy a më shumë persona juridike, të cilët kontrollohen, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga i njëjti person juridik/individ.

1.1.42 **Operatori i Sistemit të Transmetimit** është shoqëria OST Sh.a (ose person tjetër trashëgues), i cili është operatori i autorizuar i sistemit të transmetimit për sistemin kombëtar të energjisë elektrike të Republikës së Shqipërisë.

1.1.43 **Periudhe Pezullimi:** do të thotë periudha e pezullimit të Periudhës së Koncesionit, në rastet e parashikuara në këtë Kontratë.

1.1.44 **Pika e Lidhjes** është çdo pikë në të cilën Linjat e Transmetimit janë lidhur me Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike, e miratuar nga enti perkates

1.1.45 **Punimet:** janë tërësia e veprimeve për ndërtimin, komisionimin dhe vënien në punë të Hidrocentralit, në përputhje me projektin e zbatimit.

1.1.46 **Sheshi i Hidrocentralit** do të thotë sipërfaqet në të cilat do të vendoset çdo pjesë e Hidrocentralit ose strukturave të tij, duke përfshirë edhe tunelet, në të cilat do të kryhen veprimtaritë dhe shërbimet që janë pjesë përbërëse të ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së Hidrocentralit. Sheshi përfshin edhe sipërfaqet e nevojshme për punimet e përkohshme, zonat të cilat janë në mënyrë të përhershme nën ujë ose kohë pas kohe nën ujë, ose zonat që nevojiten për nxjerrjen e Materialeve të Nevojshme të Ndërtimit, bashkë me të drejtat mbi





tokën dhe të drejtat për kalim për linjat përkatëse të transmetimit dhe infrastrukturën e transportit, e cila kërkohet të ndërtohet për realizimin e Hidrocentralit, duke përfshirë rrugët dhe urat. Sipërfaqet e Sheshit identifikohen në hartat e bashkëlidhura si Aneksi 1 i kësaj kontrate.

- 1.1.47 **Garancia e Kontratës:** është vlera monetare e instrumentit financiar të sigurisë, lëshuar nga një bankë apo nga një shoqëri sigurimesh e licencuar në Republikën e Shqipërisë, që siguron interesat e Autoritetit Kontraktues, sipas nenit 17, në rastet e shkeljes së kushteve të kësaj Kontrate Koncesioni nga ana e Koncesionarit.
- 1.1.48 **Tarifa Koncesionare:** është Kompensimi që Koncesionari paguan në formën e lëvrimit të energjisë elektrike pa pagesë, në sasi të dhe mënyrat e përcaktuara sipas nenit 19 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 1.1.49 **Të Drejtat Koncesionare** janë të drejtat e Koncesionarit, të përcaktuar në Nenin 6 dhe kudo në këtë Kontratë.
- 1.1.50 **Veprim Shtetëror Thelbësish i Dëmshëm:** do të thote secila nga ngjarjet e mëposhtme;
- a) shpronësimi, konfiskimi, sekuestrimi apo shtetëzimi ose masa të tjera me efekt të njëjtë, i Hidrocentralit, apo pjesëve të tij, i të Drejtave Koncesionare apo të vetë Koncesionarit, kapitalit, aseteve apo të drejtave thelbësore të tij nga ana e Autoritetit Kontraktues ose nga ana e ndonjë Autoriteti tjetër Publik.
  - b) dështimi ose vonesat e pajustificuara, përtej afateve ligjore, nga Autoritetet Publike në dhënien e Lejeve të kërkuara nga Ligji ndërkohë që Koncesionari ka aplikuar për pajisjen me këto leje në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.;
  - c) dështimi apo vonesat e pajustificuara, përtej afateve ligjore e operatorëve të rrjetit për të lidhur Hidrocentralet në Rrjetin Kombëtar të Energjisë, sipas kërkesave të Ligjit dhe kushteve të kësaj Kontratë Koncesioni;
  - d) dështimi apo vonesat e pajustificuara, përtej afateve ligjore për vënien në dispozicion me titull të plotë e të vlefshëm të të drejtave përkatëse të përdorimit të Sheshit apo pjesëve të tij, të cilat aktualisht janë në pronësi të organeve të qeverisjes vendore apo të ndonjë Autoriteti Publik tjetër;
  - e) dështimi apo vonesat e pajustificuara, përtej afateve ligjore për vënien në dispozicion me titull të plotë e të vlefshëm të të drejtave përkatëse reale të pronësisë apo përdorimit të Sheshit apo pjesëve të tij, të cilat aktualisht janë në pronësi private dhe duhet t'i nënshtrohen procedurave të shpronësimit, me kusht që Koncesionari të ketë përballje të gjithë kostove të shpronësimit;
  - f) mosgarantimi i të Drejtës së Kalimit, aksesit dhe Gëzimit të Qetë dhe të pacenuar të Sheshit (ose çdo pjese të tij) nga Koncesionari;
  - g) ndalimi ose kufizimi i riatdhesimit ose transferimit të fitimeve ose të të ardhurave të Koncesionarit, pjesëmarrjes së aksionarëve/ortakëve dhe të shërbimeve nga Republika e Shqipërisë pa shkak ligjor (duke përfshirë ndalimin dhe kufizimet në këmbimin e monedhave të huaja);
  - h) kufizimet ose masat me efekt të ngjashëm për sa i përket punësimit të personelit të nevojshëm, pavarësisht kombësisë dhe/ose vendbanimit të tyre, përveç kufizimeve për shkaqe të lidhura me dënime penale të këtij personeli nga një gjykatë kompetente;
  - i) çdo kufizim ligjor i cili pengon Koncesionarin që lirisht të shesë ose eksportojë ndonjë pjesë të prodhimit të energjisë elektrike te ndonjë palë brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë;



- j) çdo veprim ose mosveprim i paarsyeshëm i një Autoriteti Publik si pasojë e të cilit zvogëlohet vëllimi total mesatar i ujit për prodhimin e energjise elektrike krahasuar me shifrat respektive të planifikuara në Projekt zbatim;
- k) çdo kufizim i paarsyeshëm nga një Autoriteti Publik për të përdorur burimet ujore të disponueshme në përputhje me kushtet e kontratës;
- l) Cdo detyrim, kërkesë apo pretendim shtesë i Autoritetit Kontraktues apo Autoriteteve Publike ndaj Koncesionarit, i cili nuk parashikohet shprehimisht dhe qartësisht tek detyrimet e kësaj Kontrate dhe nuk është rrjedhojë e interpretimit të saj, i cili nisur nga rrethanat është dukshëm i paarsyeshëm;
- m) Çdo veprimi tjetër i ngjashëm i Autoriteteve Publike që cenon thelbësisht:
  - i) gëzimin nga Koncesionari të çdo të drejte dhe përfitimi sipas kësaj Kontrate;
  - ii) përmbushjen nga Koncesionari të çdonjërit nga detyrimet sipas kësaj Kontrate;
  - iii) ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Hidrocentralit dhe prodhimin e energjise elektrike ose
  - iv) gëzimin nga çdo ortak të shoqërisë koncesionare të të drejtave dhe përfitimeve të cilat ai i gëzon për shkak të pjesëmarrjes në shoqërinë koncesionare.

1.1.51 **Zgjidhja pa Pasoja** do të jetë zgjidhja e kësaj Kontrate, për shkaqet e parashikuara në nenin 15 të kësaj Kontrate sipas së cilës, në rast se verifikohet, Palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, pa asnjë pretendim financiar mbi njëra tjetrën e duke përballuar kostot përkatëse siç janë bërë deri në datën e zgjidhjes së kontratës.

## 1.2 Interpretimi

- 1.2.1 Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë Koncesioni:
  - (a) Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
  - (b) Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjane;
  - (c) Çdo frazë që fillon me fjalët "*duke përfshirë*", "*përfshin*", "*në veçanti*", "*për shembull*" e të tilla si apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
  - (d) Titujt e përdorur për nenet, paragrafët, nën paragrafët, Aneksat dhe tabela e përmbajtjes janë vetëm për lehtësi referimi në interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni;
  - (e) Referimet në dispozitat dhe Aneksat janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe aneksat e kësaj Kontrate Koncesioni;
- 1.2.2 Kur afati është caktuar me "*ditë*", afati do të llogaritet në ditë kalendarike, përveçse kur përcaktohet shprehimisht në Ditë Pune. Një afat prej një ose më shumë ditësh kalendarike ose Ditësh Pune do të nisë të llogaritet duke u nisur nga dita kalendarike ose Dita e Punës në të cilën ndodh ngjarja.
- 1.2.3 Kur afati është caktuar me "*javë*", "*muaj*" ose "*vite*", atëherë afati do të llogaritet nga data në datë ("*data korresponduese*"); kur afati është caktuar në "*muaj*", nëse muaji i fundit kalendarik i periudhës përkatëse nuk ka një datë korresponduese, të ditës së muajit kalendarik kur fillon afati, atëherë afati do të përfundojë në ditën e fundit kalendarike të muajit të fundit kalendarik të periudhës.
- 1.2.4 Në rast mospërputhje midis çdo termi të përcaktuar sipas nenit 1.1 dhe një ndonjë përkufizimi tjetër në ndonjë parashikim tjetër të kësaj Kontrate Koncesioni, Aneksi apo shtojcë të ndonjë aneksi të kësaj Kontrate Koncesioni, atëherë, kuptimi i dhënë në nenin 1.1 do të ketë përparësi ndaj kuptimit të dhënë në çdo



parashikim tjetër të kësaj Kontrate Koncesioni, Aneksi apo shtojcë të ndonjë aneksi të kësaj Kontrate Koncesioni.

## Neni 2 Objekti i Koncesionit

- 2.1 Objekti i Koncesionit është dhënia nga ana e Autoritetit Kontraktues, në favor të Koncesionarit, e të drejtave koncesionare për financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, shfrytëzimin, mirëmbajtjen e Hidrocentralit të Kalivaçit dhe transferimin e tij nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, (forma BOT) kundrejt pagesës së tarifës së koncesionit, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate Koncesioni.

## Neni 3 Karakteristikat e Hidrocentralit

- 3.1 Hidrocentrali i Kalivaçit mbi lumin Vjosë do të shfrytëzojë potencialin hidroenergjetik të pellgut ujëmbledhës të lumit Vjosë, në Qarkun e Gjirokastrës dhe do të ketë karakteristikat teknike vijuese:

Kuotat e vepres :

- |   |                         |
|---|-------------------------|
| • Kuota e kreshtes se Diges                                   | 116.00.....m.m.n.d      |
| • Kuota e nivelit normal te ujit ne rezervuar                 | 110.00.....m.m.n.d      |
| • Kuota e nivelit te ujit gjate kalimit te plotes llogaritese | 113.00.....m.m.n.d.     |
| • Kuota e nivelit normal te ujit ne kanal in e shkarkimit     | 73.00..... m.m.n.d.     |
| • Fuqia e instaluar (kW)                                      | N = 111,000.00 kW.      |
| • Energjia mesatare vjetore kWh                               | E = 366,620,000 kWh/vit |

- 3.2 Karakteristikat teknike mund të pësojnë ndryshime të mundshme, në marrëveshje ndërmjet Palëve në variantin përfundimtar të projektit të zbatimit të Hidrocentralit. Koncesionari do të ketë të drejtën të propozojë ndryshime të arsyeshme dhe të justifikuara të karakteristikave teknike, deri në një limit maksimal tolerance prej +/- 20 % të fuqisë së instaluar. Ndryshimet e mundshme të propozuara nga Koncesionari, nuk do të refuzohen në mënyrë të paarsyetuar dhe të pajustificuar nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 4 Afati i Kontrates se Koncesionit

- 4.1 Hyrja në fuqi

4.1.1 Kjo Kontratë Koncesioni dhe të drejtat e detyrimit e Palëve do të hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja Palët ("Data e Hyrjes në Fuqi") dhe do të mbetet në vijim në fuqi dhe me efekte të plota deri në Datën e Mbarimit (d.m.th. përvjetori i 35-të i Datës së Hyrjes në Fuqi), apo në Datën e Shtyrë të Mbarimit, në rastet e parashikuara sipas nenit 4.1.2 këtu më poshtë, përveçse kur kjo Kontratë Koncesioni zgjidhet sipas parashikimeve të nenit 15, dhe në këtë rast afati përfundon në Datën e Zgjidhjes.

4.1.2 Palët bien dakord se, në rast të një Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktues, të një Ngjarje të Forcës Madhore ose të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të

Dëmshëm, të njoftuar nga Koncesionari dhe që ndikojnë thelbësisht në përmbushjen e detyrimeve të tij të përcaktuara në këtë kontratë, afatet kohore të përcaktuara në këtë kontratë, do të shtyhen për aq kohë sa ka zgjatur Mospërmbushja e Autoritetit Kontraktues. Ngjarja e Forcës Madhore ose Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm.

#### 4.2 Zgjatja e Periudhës së Koncesionit pas Datës së Mbarimit apo Datës së Shtyrë të Mbarimit

- 4.2.1 Palët bien dakord se Periudha e Koncesionit mund të zgjatet nëse është e nevojshme, duke u bazuar në një marrëveshje tjetër, në përputhje me parashikimet e Ligjit të Koncesioneve, në përputhje me kohën e përshtatshme për të konsideruar projektin fitimprurës dhe financiarisht të përshtatshëm, në përputhje me analizën financiare të "vlerës për para", "IRR" ose çdo analizë tjetër të përshtatshme për këtë vlerësim.

### Neni 5

#### Transferimi dhe dorëzimi i Aseteve Ekzistuese

- 5.1 Palët janë në dijeni të faktit se ndërtimi i hidrocentralit të Kalivaçit, ka qenë objekt i një procedure të mëparshme koncesioni të kryer nga Autoritetet Publike shqiptare me një subjekt privat koncesionar të mëparshëm, me të cilin ka qenë nënshkruar edhe një kontratë koncesioni, e cila tashmë është zgjidhur. Për pasojë, në Shesh ndodhen disa Asete Ekzistuese, të cilat do t'i jepen Koncesionarit nga Autoriteti Kontraktues për qëllimet e realizimit të Hidrocentralit objekt i kesaj kontrate.
- 5.2 Për sa i përket, transferimit dhe dorëzimit të asetëve ekzistuese, Palët bien dakord se brenda 1 (një) muaji nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, Palët do të krijojnë Njësinë e Transferimit dhe Dorëzimit të Asetëve Ekzistuese (NJTDAE) e cila do të përbëhet dhe do të ketë kompetencat e mëposhtme;
- NJTDAE do të përbëhet nga pese anëtarë që do të caktohen si më poshtë:
    - tre anëtarë, të caktuar nga Autoriteti Kontraktues; dhe
    - dy anëtarë, të caktuar nga Koncesionari.
  - Brenda 3 (tre) muajsh nga krijimi i saj, NJTDAE do të kryejë procesin e identifikimit, verifikimit dhe vlerësimit të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, asetëve, pajisjeve, makinerive apo materialeve ekzistuese të Sheshit ("Asetet Ekzistuese"), të përfshira në dokumentet e tenderit, për të cilat Koncesionari ka paraqitur ofertën financiare përkatëse;
  - Pas identifikimit, verifikimit dhe vlerësimit të Asetëve Ekzistuese, nëse ka mospërputhje midis asetëve të deklaruara në fazën e tenderit nga ato efektivisht të verifikuara nga NJTDAE, brenda 30 ditësh, do të kryhet edhe reflektimi dhe rishikimi i çmimit përkatës që duhet paguar nga Koncesionari. Në rast konflikti mbi vlerën e Asetëve Ekzistuese, vlerësimi dhe vendimi final do të merret brenda 60 diteve nga Eksperti i Pavarur i perzgjedhur nga palët dhe me kompetencat sipas nenit 30. Brenda 30 diteve nga vendimi final i Ekspertit të Pavarur, Koncesionari duhet të japë miratimin e tij për këtë vendim, nëse e pranon vlerën e përcaktuar nga ky i fundit, apo nëse do të vijojë me të drejtën për zgjidhur kontratën, sic parashikohet në nenin 15.1 e kontratës "Koncesionari mund ta zgjidhë këtë Kontratë pa pasojë financiare për palët, në rast se vlera e Asetëve Ekzistuese e përcaktuar nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik është më e lartë se vlera e ofertës së Koncesionarit". Vendimi i ekspertit është përfundimtar dhe nuk i nënshtrohet procedurës së Arbitrazhit.



- Nëse vlera e asetëve të përlogaritura nga Eksperti do të vlerësohet më e ulët se oferta e Koncesionarit, në cdo rast do të merret në konsideratë oferta e koncesionarit në procedurën konkurruese.
- d) Në përfundim të kësaj procedure, Asetet Ekzistuese do t'i transferohen dhe dorëzohen Koncesionarit, së bashku me Sheshin, nëpërmjet një Procesverbali Dorëzimi të nënshkruar nga NJTDAE. Procesverbali i Dorëzimit do të identifikojë dhe listojë të gjitha Asetet Ekzistuese, do i bashkëlidhet si Aneks kësaj Kontrate dhe do të përbëjë pjesë integrale të saj;
- 5.3 Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e lidhura me Asetet Ekzistuese të transferuara dhe të dorëzuara te Koncesionari, Autoriteti Kontraktues njeh dhe merr përsipër detyrimet e mëposhtme;
- a) Autoriteti Kontraktues merr përsipër t'i transferojë Koncesionarit Asetet Ekzistuese të pajisura me titull të plotë pronësie, përdorimi apo të barazvlefshëm, me përjashtim të pronave private të cilat do t'i nënshtrohen procedurave të shpronësimit;
- b) Autoriteti Kontraktues merr përsipër t'i japë Koncesionarit informacion dhe dokumentacion të plotë dhe të saktë në lidhje me procedurat e mëparshme të shpronësimit të hidrocentralit, nëse janë kryer, përfshirë dhe transferimet apo ndryshimet e kryera në titujt e pronësisë së pronave private të Sheshit;
- c) Autoriteti Kontraktues merr përsipër t'i transferojë Koncesionarit Asetet Ekzistuese të lira nga çdo barrë, peng, hipotekë apo kufizime të ngjashme;
- d) Në rast se Asetet Ekzistuese nuk rezultojnë të përshtatshme për realizimin e Hidrocentralit, Koncesionari ka të drejtë ti refuzojë ato, duke kërkuar reduktimin e vlerës së tyre;
- e) Koncesionari nuk do të jetë përgjegjës, në asnjë rast, në lidhje me pretendimet që mund të ketë çdo palë e treta mbi Asetet Ekzistuese dhe të drejtat apo detyrimet e lidhura me to.
- f) Autoriteti Kontraktues merr përsipër që çdo pretendim të palëve të treta të paraqitur në rrugë administrative apo gjyqësore, ta kundërshtojë vetë.
- g) Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar Koncesionarin nga çdo kërkesë, pretendim me efekt financiar të kërkuar nga palët e treta që lidhet me Asetet Ekzistuese të krijuara/ndertuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
- 5.4 Çdo vonesë, pengesë apo dëm që i shkaktohet Koncesionarit nga pretendimet në lidhje me Asetet Ekzistuese, sipas dispozitave të mësipërme 5.3.a – 5.3.g do të konsiderohet si Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm dhe do të përbëjë shkak për kushte lehtësuese.
- 5.5 Koncesionari do të ketë të drejtë të përdorë, ndryshojë, heqë dhe rindërtojë Asetet Ekzistuese nëse këto ndryshime do të jenë të nevojshme për realizimin e Hidrocentralit.
- 5.6 Koncesionari do të kryejë pagesën përkatëse të Aseteve Ekzistuese, sipas vlerësimit të kryer në përputhje me dispozitat e këtij neni, duke i paguar ato me këste nga momenti i fillimit të prodhimit të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të nenit 19 të kësaj kontrate.

## KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

### Neni 6 Të Drejtat Koncesionare - Sheshi

## 6.1 Dhënia e të Drejtave Koncesionare

6.1.1 Duke nisur nga Data e Hyrjes në Fuqi të Kontratës së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues i jep Koncesionarit për të gjithë Periudhën e Koncesionit, (i cili pranon), të drejtat e mëposhtme, (së bashku "Të Drejtat Koncesionare"):

- (a) të financojë, projektojë, ndërtojë, testojë, vërë në punë, operojë, administrojë, shfrytëzojë dhe të mirëmbajë Hidrocentralin, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë Koncesioni;
- (b) të ketë të Drejtën e Kalimit dhe Gëzimin e Qetë të Sheshit, siç parashikohen nga Neni 6.2;
- (c) të përdorë burimet ujore të Lumit Vjosë për realizimin e Objektivit të Koncesionit, në përputhje me këtë Kontratë Koncesioni, duke respektuar kushtet mjedisore dhe rrjedhën ekologjike sipas Lejeve;
- (d) të përdorë, pa pagesë tokën, asetet publike, Materialet e Nevojshme të Ndërtimit të ndodhura në, mbi dhe nën Shesh, pasi të pajiset me lejet perkatese të lejuara sipas legjislacionit në fuqi, vetëm për qëllime të zbatimit të Objektivit të Koncesionit.
- (e) Për këtë qëllim Palët do të lidhin dhe rinovojnë menjëherë pa ndërprerje, marrëveshje të posaçme uzufukti, përdorimi, me kohëzgjatje sipas rastit, por jo më shumë se periudha e koncesionit.
- (f) të shesë një pjesë apo të gjithë energjinë e prodhuar prej Hidrocentralit, duke përfshirë këtu të drejtën për të përfituar certifikata të gjelbra, apo ndonjë incentivë tjetër mjedisore, në lidhje me prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme;
- (g) të lidhet, të ketë akses në Rrjetin Kombëtar të Energjisë, me kapacitet të plotë dhe në përputhje me karakteristikat teknike të Hidrocentralit, dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit të Energjisë Elektrike dhe legjislacionin në fuqi;
- (h) Koncesionari do të ketë të drejtë të hipotekojë, të vendosë barrë, apo të transferojë të drejtat e tij në këtë Kontratë si dhe interesat e tij mbi projektin, përfshirë dhe ato që i nënshtrohen kontratave të tjera në lidhje me Sheshin, për qëllimin e vendosjes së garancive në favor të Palëve Financuese për financimin e projektit, vetëm pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues.
- (i) me mbarimin e Periudhës së Koncesionit t'i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e Sheshit dhe të Drejtën për Kalim, dhe t'i transferojë Autoritetit pronësinë e Hidrocentralit dhe të objekteve ekzistuese (nëse ka) të cilat të jenë në gjendje të mirë pune, si dhe, në çdo rast, të kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjydhshëmrisht të lidhura me këto aktivitete;
- (j) Koncesionari do të ketë të drejtën ndaj çdo atributi mjedisor që mund të gjenerohet nga Projekti, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në certifikatat Certified Emission Reductions (CER).

## 6.2 Dhënia e Sheshit

6.2.1 Pa vonesa pas Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, Autoriteti Kontraktues do t'i japë Koncesionarit të drejtën e Sheshit, të Drejtën e Kalimit dhe do t'i garantojë Gëzimin e Qetë, me të vetmin kusht që Koncesionari t'i ketë paraqitur Autoriteti Kontraktues, kopje autentike të certifikatave të sigurimit, të cilat vërtetojnë (në masën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues), se Koncesionari është i pajisur me të gjitha policat e sigurimit dhe

garancitë e kërkuara për këtë qëllim, në përputhje me nenin 18 të kësaj Kontrate Koncesioni.

- 6.2.2 Në këtë kuadër, dhe pa cenuar detyrimet e tij kontraktore Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit në marrëdhëniet me Palë të Treta, në mënyrë që të shmanget çdo pengesë, që mund të haset në kuadër të shpronësimeve apo çdo lloji tjetër pengese, në lidhje me titujt përkatës të përdorimit të tokës dhe Aseteve Ekzistuese dhe regjistrimin e tyre në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, për t'i siguruar Koncesionarit të Drejtën e Kalimit dhe Gëzimin e Qetë të Sheshit, për realizimin e punimeve dhe operimin normal të Hidrocentralit. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm, kur moszgjidhja e pengesave të mësipërme, vjen si rezultat i mos përmbushjes së kërkesave ligjore përkatëse, për shkak të veprimeve të fajshme të Koncesionarit.
- 6.2.3 Palët bien dakord që nëse i gjithë Sheshi apo pjesë e tij, është pronë private, dhe Koncesionari, pavarësisht përpjekjeve, nuk ka arritur të merret vesh me pronarët private, në terma të arsyeshëm, për fitimin e të drejtave të përshtatshme të përdorimit me qëllim zbatimin e Objektivit të Koncesionit, atëherë Koncesionari ka të drejtë të kërkojë shpronësimin për interes publik sipas ligjit, të pasurive private që mund të përfshihen në Shesh, me kusht që Koncesionari të përballojë të gjitha kompensimet, kostot dhe shpenzimet e lidhura me shpronësimet, në përputhje me çmimet e referencës të përcaktuar sipas Ligjit. Çdo pengesë apo dëm që i shkaktohet Koncesionarit i cili rrjedh nga pamundësia për të përdorur Sheshin si pasojë e vonesave të shkaktuara nga Autoritetet Publike, qendrore apo vendore, përtej afateve ligjore të procesit të shpronësimeve, do të përbëjë shkak për shtyrje të afatit të përcaktuar për perfundimin dhe venien në punë të Veprës.
- 6.2.4 Palët bien gjithashtu dakord që nëse i gjithë apo pjesë të tokës apo asetëve publike të Sheshit, nuk janë në pronësi/administrim të Autoritetit Kontraktues, atëherë Autoriteti Kontraktues do të asistojë Koncesionarin në marrjen, nga Autoriteti Publik përkatës që ka në pronësi/administrim tokën/asetin, e një titulli të vlefshëm përdorimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, në një mënyrë që të mos pengohet realizimi i projektit. Për këtë qëllim, Autoriteti Kontraktues do të ndihmojë/asistojë Koncesionarin për zgjidhjen brenda afateve të arsyeshme të çdo konflikti apo mosmarrëveshjeje të mundshme me Autoritetet Publike. Çdo vonesë, pengesë që i shkaktohet Koncesionarit i cili rrjedh nga pamundësia për të përdorur Sheshin, do të përbëjë shkak për shtyrjen e afatit të perfundimit dhe venies në punë të Veprës.
- 6.2.5 Në lidhje me dhënien e Sheshit, të Drejtës së Kalimit, garantimin e Gëzimit të Qetë dhe të drejtës për akses dhe për të përdorur ujin e Lumit të Vjosës, Koncesionari e pranon Sheshin "siç është" në datën e perfundimit të transferimit dhe dorëzimit të Aseteve Ekzistuese sipas Procesverbalit të Dorëzimit. Pa cënuar parashikimet e mësipërme, Autoriteti Kontraktues do të mbrojë Koncesionarin nga çdo pretendim i ndonjë Pale të Tretë ndaj Koncesionarit, në lidhje me pronat dhe asetet që përbëjnë Sheshin si dhe për të Drejtat Koncesionare në tërësi. Për këtë qëllim Autoriteti Kontraktues merr përsipër që çdo pretendim të palëve të treta mbi Sheshin dhe të Drejtat Koncesionare, të paraqitur në rrugë administrative apo gjyqësore, ta zgjidhë apo kundërshtojë vetë, duke u

përfaqësuar veçmas apo krahas Koncesionarit, nëse ky i fundit do të jetë palë e paditur.

- 6.2.6 Të gjitha pronat e paluajtshme të Sheshit do të jenë në pronësi shtetërore, të Autoritetit Kontraktor apo të Autoriteteve Publike, përfshirë edhe pronat private që do të shpronësohen dhe objektet e reja që mund të ndërtohen nga Koncesionari. Për pasojë, asnjë taksë, tatim, tarifë apo pagesë tjetër nuk do të kërkohej dhe nuk do të paguhet në asnjë rast nga Koncesionari, në lidhje me pasuritë e paluajtshme të Hidrocentralit, përfshirë por pa u kufizuar: truallin, ndërtesat, tunelet, rrjedhën e lumit dhe pellgun ujëmbledhës, tokat bujqësore, pyjet, kullotat dhe livadhet, rrugët dhe infrastrukturën e brendshme. Për të shmangur çdo keqkuptim, Koncesionari do të paguajë vetëm ato detyrime/taksa që ngarkon ligji përkatës në mënyrë specifike për t'i paguar.
- 6.2.7 Autoriteti Kontraktues do t'i japë Koncesionarit mbi të gjitha pjesët e Sheshit, uzufuktin ose të drejtat përkatëse të nevojshme për realizimin e Projektit (p.sh. të drejta ndërtimi, qira afatgjata ose, sipas rastit të drejta përdorimi ose të drejta kalimi). Këto të drejta reale të pronësisë, për sa i përket Shesheve do të evidentohen në kontrata të shkruara ndërmjet Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues (ose Autoriteteve Publike të tjera) me kushte që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi
- 6.2.8 Të gjitha Materialet e Nevojshme të Ndërtimit që ndodhen në Sheshin e Hidrocentralit, do të konsiderohen të përfshira tek të Drejtat Koncesionare dhe do të përdoren nga Koncesionari, sipas legjislacionit që rregullon marrëdhëniet në fushën përkatëse.
- 6.3 Hidrocentralet në rrjedhën e sipërme
- 6.3.1 Autoriteti Kontraktues garanton Koncesionarin që, ai apo ndonjë Autoritet Publik tjetër, nuk do të japë ndonjë të drejtë një Pale të Tretë për të kontrolluar, shfrytëzuar, devijuar ose shkarkuar rezervat ujore në pjesën e sipërme të Sheshit ("Hidrocentralet në Rrjedhën e Sipërme") dhe (i) ndërtimi dhe operimi i këtyre Hidrocentraleve në Rrjedhën e Sipërme nuk do të zvogëlojë prurjet ditore që do të kishin ardhur në Hidrocentral, sipas rrjedhës natyrale; (ii) regjimi operacional i këtyre Hidrocentraleve në Rrjedhën e Sipërme nuk do të ndikojë negativisht në regjimin/funksionimin e Hidrocentralit.
- 6.3.2 Autoriteti Kontraktues do të mbrojë dhe do të mbajë Koncesionarin të pacënuar nga çdo dhe të gjitha humbjet e shkaktuara si më sipër, përfshirë por pa u kufizuar në humbjet monetare dhe do të marrë masa për rregullimin e shkeljeve brenda 60 ditëve, në përputhje me mekanizmat e korrigjimit të shkeljeve sipas nenit 23 të kësaj kontrate.
- 6.3.3 Për çdo pengesë, dëm, humbje dhe/ose zvogëlim i fitimit që i shkaktohet Koncesionarit si rrjedhojë e pasojave negative nga hidrocentralet në rrjedhën e Sipërme, Koncesionari gëzon të drejtën të ushtrojë zgjidhjen e kontratës në përputhje me nenin 15.4 të kësaj Kontrate Koncesioni.

#### 6.4 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve



- 6.4.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Koncesionari është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 6.4.2 Për çdo pengesë, dëm, humbje dhe/ose zvogëlim të fitimeve që i shkaktohen Koncesionarit si rezultat i pasojave negative të ndryshimit të ligjeve, rregulloreve, urdhëresave, urdhrave ose procedurave, Koncesionari ka të drejtë të kompensohet sipas Aneksit 4d. Nëse kompensimi nuk e kthen koncesionarin në gjendjen e mëparshme, brenda 90 ditëve, atëherë Koncesionari do të ketë të drejtën të zgjidhë kontratën në përputhje me nenin 15.4 të kësaj kontrate koncesioni.

## **Neni 7 Mbikëqyrja dhe Monitorimi**

### **7.1 Mbikëqyrja e Përgjithshme dhe Monitorimi**

- 7.1.1 Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë Periudhës së Koncesionit, nëpërmjet personave të autorizuar dhe me shpenzimet e veta, të mbikëqyrë zbatimin e punimeve të ndërtimit, të monitorojë progresin e zbatimit të Objektivit të Koncesionit dhe të verifikojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Kontratë Koncesioni, në të gjitha fazat e zbatimit të saj.
- 7.1.2 Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë mbikëqyrje të përgjithshme dhe monitorim në çdo kohë, në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin nga ana e Koncesionarit, të detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate Koncesioni. Rezultatet e monitorimit do t'i bëhen të njohura Koncesionarit, me shkrim.
- 7.1.3 Në rast se gjatë veprimtarisë së mbikëqyrjes së përgjithshme dhe monitorimit, Autoriteti Kontraktues vëren shkeljeve të Kontratës së Koncesionit nga ana e Koncesionarit, atëherë Koncesionari do të njoftohet me shkrim, dhe Autoriteti Kontraktues do të propozojë masa korigjuese dhe afatet e zbatimit të tyre.

## **Neni 8 Detyrimet e Autoritetit Kontraktues**

Përtej detyrimeve të marra përsipër diku tjetër në këtë Kontratë Koncesioni, Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- 8.1 Të sigurojë vazhdimësinë e kësaj Kontrate Koncesioni, pavarësisht ndryshimeve të objektivave të Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar.
- 8.2 Të transferojë dhe dorëzojë Asetet Ekzistuese tek Koncesionari, sipas Procesverbalit të Dorëzimit të nënshkruar nga NJTDAE.
- 8.3 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit merr përsipër të ndihmojë dhe asistojë këtë të fundit tek Autoritetet Publike për çdo pengesë që mund të haset në

kuadër të pajisjes me Leje, licenca, autorizime apo çdo lloj tjetër miratimi që nevojitet për ekzekutimin e punimeve dhe operimin e kësaj veprë. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licencë, autorizim, vjen si rezultat i mospërbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Koncesionarit.

- 8.4 Të miratojë projektin e zbatimit të Hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Koncesionari, të dorëzuar në afat dhe në përputhje oferten e paraqitur në procedurën konkurruese si dhe me kërkesat teknike për ndërtimin e objekteve hidroenergjetike, brenda një afati jo më shumë se 3 muaj.
- 8.5 Të ndihmojë dhe asistojë Koncesionarin në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me Autoritetet Publike/operatorë të sektorit elektroenergjetik, për qëllime të realizimit të Objektivit të Koncesionit.
- 8.6 T'i garantojë Koncesionarit të Drejtat Koncesionare të parashikuara në nenin 6, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 8.7 Të garantojë Koncesionarin se ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike nuk do të ndikojë negativisht në interesat e Koncesionarit, të percaktuara në këtë Kontratë Koncesioni.
- 8.8 T'i garantojë Koncesionarit lidhjen e Hidrocentralit me Rrjetin Kombëtar të Energjisë për transmetimin e energjisë, për të gjithë kapacitetin e instaluar në përputhje me Kodin e Rrjetit, legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 8.9 Autoriteti Kontraktues i garanton Koncesionarit me qëllim operimin e pandërprerë të Hidrocentralit, akses të plotë në Rrjetin Kombëtar të Energjisë.
- 8.10 Në rast se përgjatë periudhës së koncesionit, për qëllimet e realizimit të Hidrocentralit, do të jetë e nevojshme kryerja e punimeve për të cilat nevojitet zgjatja e orëve të punës të lejuara nga legjislacioni i punës, Autoriteti Kontraktues do të ndihmojë Koncesionarin për marrjen e miratimeve nga Autoritetet Publike.
- 8.11 Autoriteti Kontraktues, me kërkesë të Koncesionarit, kryen procedurën e shpronësimit për pasuritë në pronësi private (nëse ka), të cilat do të shfrytëzohen për ndërtimin e Hidrocentralit, me kusht që Koncesionari të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore për këtë shpronësim, si dhe të paguajë shpenzimet e shpronësimit.

### KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONCESIONARIT

#### Neni 9 Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë Objektivin e Koncesionit, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate Koncesioni. Në veçanti, Koncesionari duhet:

- 9.1 Të ketë paraqitur, brenda 12 (dymbëdhjete) muajve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate Koncesioni, për miratim pranë Autoritetit Kontraktues, projektin e zbatimit të Hidrocentralit.

- 9.2 Të pajiset në përputhje me Ligjin, me të gjitha Lejet e nevojshme për realizimin e kësaj Kontrate Koncesioni.
- 9.3 Të zbatojë grafikun e punimeve të paraqitur në oferte (në procedurën konkurruese) sipas Aneksit 3 bashkëlidhur kësaj Kontrate Koncesioni, siç mund të përditësohet kohë pas kohe, me miratim nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.4 Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara në Aneksin 2 dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë Koncesioni.
- 9.5 Të zbatojë projektin për ndërtimin e Hidrocentralit, sipas karakteristikave teknike të dhëna në ofertë dhe të përcaktuara në Nenin 3 të kësaj kontrate.
- 9.6 Të administrojë Hidrocentralin për Periudhën e Koncesionit.
- 9.7 Të marrë masat e nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe rehabilitimin e çdo ndotje mjedisore të shkaktuar nga Punimet e kryera gjatë ndërtimit dhe funksionimit të Hidrocentralit, për kthimin e tij, me shpenzimet e veta, në gjendjen e mëparshme sipas detyrimeve të përcaktuara nga Lejet/autorizimet të lëshuara nga autoritetet përkatëse.
- 9.8 Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë të rëndësishme që ndikon negativisht në ecurinë e Punimeve.
- 9.9 Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjenes dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë;
- 9.10 Të respektojë përcaktimet dhe kufizimet të cilat lidhen me burimet ujore që furnizojnë ujësjellësin e zonës, ruajtjen e ekosistemit natyror, të sasisë së ujit të përcaktuar si rrjedhë ekologjike në shtratin parësor të burimit ujor dhe ujin e nevojshëm për vaditje në përputhje me rregullat ligjore në fuqi dhe sipas miratimit të marrë nga institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve të përdorimit të ujit.
- 9.11 Të garantojë dhe të respektojë veprimtarinë normale të të gjithë veprave hidroteknike si dhe çdo veprimtari tjetër publike apo private që gjendet në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme të Hidrocentralit.
- 9.12 Të zhdëmtojë të gjitha dëmet e shkaktuara palëve të treta.
- 9.13 Të zbatojë dhe respektojë të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin Shqiptar për Digat
- 9.14 Të zbatojë Ligjin në veprimtarinë e tij për implementimin e Objektivit të Koncesionit.

#### **Neni 10**

##### **Zëvendësimi i Infrastrukturës ekzistuese që do të bëhet e papërdorshme**

- 10.1 Koncesionari do të ndërtojë/ rindërtojë ose zëvendësojë (sipas rastit) infrastrukturën ekzistuese në gjendjen "siç është", e cila do të përmytet ose do të bëhet e papërdorshme si pasojë e realizimit të Vepres. Për të shmangur çdo dyshim, asetet

zëvendësuese te ndertuara/rindertuara, duhet të kenë të njëjtat kushte me ato ekzistuese.

- 10.2 Nëse Palët nuk arrijnë të bien dakord për kushtet e kësaj infrastrukture ose kostove përkatëse brenda 60 ditësh, ato do të percaktohen nga Eksperti i Pavarur, brenda 30 ditësh.
- 10.3 Për sa më sipër, Koncesionari nuk do të ketë asnjë detyrim tjetër përveç atyre të percaktuara në Nenin 10.1 dhe 10.2, për të kompensuar si Autoritetin Kontraktues ashtu edhe ndonjë palë të tretë për të njëjtin objekt të infrastrukturës zëvendësuese.

### **Neni 11 Investimi**

- 11.1 Mbi bazën e të dhënave të studimit të fizibilitetit, investimet që parashikohen të kryhen nga Koncesionari janë në vlerën totale prej 16,913,853,000 Lekë, pa TVSH, siç detajohet në preventivin bashkëlidhur si Aneksi 2. Ky preventiv përfshin edhe vlerën që do të investohet në makineri e pajisje.
- 11.2 Vlera e mësipërme mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet Palëve:
- në rast se ka ndryshime në vlerësimin e Aseteve Ekzistuese, në përputhje me dispozitat e nenit 5;
  - në rast se ka ndryshime të karakteristikave teknike, në përputhje me dispozitat e nenit 3;
  - pas miratimit të projektit të zbatimit;
  - në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit në ndërtimin e Hidrocentralit.
- 11.3 Vlerësimi i investimit do të bëhet mbi bazën e situacioneve tre mujore, te cilat do të jenë të depozituara/deklaruara në organet tatimore sipas ligjit.
- 11.4 Vlerësimi përfundimtar i investimit do të bëhet, nga një ekspert vlerësues i pavaruar i emëruar nga Autoriteti Kontraktues i cili do të paguhet nga Koncesionari, pasi ky i fundit të jete pajisur me Certifikatën e pranimit të veprës.

### **Neni 12 Programi i Punimeve**

Koncesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të Punimeve:

- 12.1 Koncesionari merr përsipër të përfundojë ndërtimin e vërë në punë Hidrocentralin Kalivac brenda 30 (tridhjetë) muajve nga data e marrjes së lejeve. Afati për pajisjen me lejet e nevojshme është jo më shumë se 24 (njëzet e katër) muaj nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate koncesioni.
- 12.2 Koncesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 60 ditëve nga data e pajisjes me të gjitha lejet e nevojshme për fillimin e punimeve të ndërtimit. Fillimi i punimeve do të vërtetohet nëpërmjet një procesverbali të nënshkruar mes palëve. Nëse Autoriteti Kontraktues nuk merr pjesë në nënshkrimin e këtij procesverbali, atëherë Koncesionari i njofton Autoritetin Kontraktues nisjen e punimeve.



- 12.3 Brenda kuadrit të zbatimit të Punimeve për realizimin e projektit (ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, siç mund të ndryshohet, dhe akteve përkatëse nënligjore, siç mund të shtohen apo zëvendësohen herë pas here), Koncesionari do të caktojë një subjekt në rolin e mbikëqyrësit të Punimeve, i cili do të konfirmohet nga Autoriteti Kontraktues. Ky subjekt mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
- 12.4 Koncesionari merr përsipër të realizojë Punimet në përputhje me Programin e Punimeve të parashikuar nga Aneksi 3 i kësaj Kontrate Koncesioni.
- 12.5 Palët bien dakord se afati i punimeve do të zgjatet në rastet kur ndodhin Mospërmbushje të Autoritetit Kontraktues, Ngjarje të Forcës Madhore ose Veprime Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme, për një periudhë të njëjtë me Periudhën e Pezullimit të parashikuar në këtë Kontrate Koncesioni.

### **Neni 13**

#### **Testimet, Komisionimi dhe Vënia në Punë e Veprës**

- 13.1 Me përfundimin e punimeve në Hidrocentral, Koncesionari njofton Autoritetin Kontraktues lidhur me situatën dhe kërkon nga ky i fundit pjesëmarrjen në kryerjen e testeve për plotësimin e parametrave teknike sipas Nenit 3 të kësaj Kontrate Koncesioni. Testimet do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues ose të autorizuarit prej tij dhe të Koncesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për plotësimin e parametrave teknikë në përputhje me dispozitat e nenit 3 të kësaj Kontrate Koncesioni.
- 13.2 Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues. Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit Kontraktues gjatë testimit, Koncesionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të Hidrocentralit, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 ditëve nga testimi dhe vënia në punë.
- 13.3 Në përfundim të etapave të mësipërme, si dhe pas kryerjes së komisionimit të veprës nëpërmjet një personi apo subjekti të licensuar, Autoriteti Kontraktues duhet të nënshkruajë Certifikatën e Pranimit të Veprës për Hidrocentralin, e cila do të konsiderohet e dhënë nëse ky i fundit nuk përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga testimi, komisionimi dhe vënia në punë e Hidrocentralit.

### **KREU IV TË NDRYSHME**

#### **Neni 14**

#### **Mospërmbushjet, Forca Madhore dhe Veprimet Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme**

##### **14.1 Ngjarjet e Mospërmbushjes**

- 14.1.1 Në rast të një Mospërmbushje nga Koncesionari ose të një Mospërmbushje nga Autoriteti Kontraktues, Koncesionari ose Autoriteti Kontraktues, sipas rastit, do t'i paraqesë Palës tjetër ("Pala në Mospërmbushje") një njoftim me shkrim duke kërkuar korrigjimin e Mospërmbushjes, sipas dispozitave të nenit 23 të kësaj

kontrate. Dështimi nga Pala në mospërbushje për të korrigjuar Mospërbushjen brenda afatit të korrigjimit, do të përbëjë shkak për Kompensim sipas dispozitave të Aneksive 4a dhe 4b dhe/ose shkak për Zgjidhje sipas kësaj Kontrate Koncesioni.

14.1.2 Në rast të ndonjë Mospërbushje të detyrimeve nga Autoriteti Kontraktues, apo nga ndonjë Autoritet Publik tjetër i cili i shkakton Koncesionarit vonesa jo për faj të tij, afati për realizimin e detyrimeve e këtij të fundit do të shtyhet për aq kohë sa ka qenë edhe koha e vonesës së shkaktuar nga Autoriteti Kontraktues ose Autoritet Publik tjetër. Gjatë kësaj periudhe Koncesionari do të çlirohet nga përgjegjësia për përbushjen e të gjitha detyrimeve që pengohen nga këto Mospërbushje të Autoritetit Kontraktues.

#### 14.2 Ngjarjet e Forcës Madhore

14.2.1 Palët bien dakord që ato nuk do të kenë të drejtë të ngrenë pretendime për mospërbushje kontraktore sipas kësaj Kontrate Koncesioni ndaj Palës tjetër, për aq sa kohë sa këto Mospërbushje, shkaktohen nga një Ngjarje e Forcës Madhore. Pala përkatëse që nuk mund të përbushë detyrimet e saj për shkak të një Ngjarje e Forcës Madhore, duhet të njoftojë me shkrim Palën tjetër, pa vonesë. Në vijim të ndonjë Ngjarje e Forcës Madhore, të dyja Palët do të bëjnë çfarë është e mundur, në mënyrë të arsyeshme, për të reduktuar pasojat e Ngjarjes së Forcës Madhore.

14.2.2 Nëse një Ngjarje e Forcës Madhore ose pasojat e saj, vazhdojnë për një periudhë më të gjatë se 3 muaj, duke bërë të pamundur për Palën e prekur të përbushë detyrimet e saj sipas kësaj Kontrate Koncesioni, atëherë, kjo do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje, të ushtrueshme nga secila Palë sipas nenit 15.5 të kësaj Kontrate Koncesioni.

14.2.3 Kompensimet e mundshme të zbatueshme në rastet e Forcës Madhore, do të rregullohen nga dispozitat e Aneksit 4c.

#### 14.3 Veprimet Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme

14.3.1 Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga ngjarja e një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari do të njoftojë Autoritetin Kontraktues dhe Autoritetin Kontraktues do të sigurojë korrigjimin e Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm në fjalë.

14.3.2 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk do të korrigojë Veprimin Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm përpara përfundimit të një periudhe prej 90 ditë nga njoftimi me shkrim i Koncesionarit, dhe/ose korrigjimi i ofruar nuk kënaq Koncesionarin, Palët do të diskutojnë pa vonesë me qëllim arritjen e një zgjidhje të kënaqshme për të dyja palët për të rivendosur Koncesionarin në pozitën që do të ishte nëse ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm të mos kishte ndodhur. Dështimi nga Autoriteti Kontraktues për të korrigjuar apo rivendosur Koncesionarin në pozicionin e mëparshëm, brenda këtij afati (ose nëse Autoriteti Kontraktues ka dështuar apo refuzuar të diskutojë), do të përbëjë një Ngjarje Zgjidhje, të ushtrueshme nga Koncesionari në përputhje me nenin 15.4. Gjatë kësaj periudhe

Koncesionari do të çlirohet nga përgjegjësia për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që pengohen nga këto Veprime Shtetërore Thelbësisht të Dëmshme.

- 14.3.3 Nëse përmbushja nga Koncesionari e detyrimeve të tij sipas Kontratës pengohet, vështirësohet apo vonohet në çdo kohë nga një Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm, Autoritet Kontraktues do t'i japë Koncesionarit të drejtën për shtyrjen e ndonjë date përfundimi ose të planifikuar për aq sa zgjat ky Veprim Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm;
- 14.3.4 Autoritet Kontraktues njeh dhe pranon se Veprimi Shtetëror Thelbësisht i Dëmshëm i pakorrigjuar, në përputhje me dispozitat e Nenit 14.3.2 më sipër, përbën shkak për zgjidhje të kontratës
- 14.3.5 Kompensimi në rastet e Veprimit Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm do të kryhet në përputhje me dispozitat e Aneksit 4b dhe 4d.

#### **Neni 15 Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit**

- 15.1. Koncesionari mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni, pa pasoja financiare për ndonjërin nga Palët në rast të verifikimit të ndonjërit prej kushteve të mëposhtme;
- a) Nëse Raporti Mjedisor mbi Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor për ndërtimin e Hidrocentralit, i bazuar në Standardet e Performancës mbi Mjedisin dhe Qëndrueshmërinë Sociale të zbatueshme sipas International Finance Corporation (IFC Performance Standards on Environmental and Social Sustainability), i hartuar nga një konsulent ndërkombëtar i pavarur, verifikon se ndërtimi i hidrocentralit nuk është në përputhje me standartet mjedisore;
  - b) Deshtimi në Sigurimin e Financimit, të ardhur si pasojë e rezultateve negative të Raportit Mjedisor, sipas parashikimeve të paragrafit të mësipërm;
  - c) në rast se vlera e Aseteve Ekzistuese e përcaktuar nga Eksperti Teknik dhe Ekonomik ose NJTDAE është më e lartë se vlera e ofertës së Koncesionarit.
- 15.2. Në rast se verifikohet Zgjidhja e Parakohshme Pa Pasoja, Palët do të kthehen në gjendjen e mëparshme përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, pa patur asnjë pretendim financiar mbi njëra tjetrën dhe pa Pasoja.
- 15.3 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës së Koncesionit nga Autoriteti Kontraktues, për shkak të Mospërmbushjes së detyrimeve nga Koncesionari.
- 15.3.1 Autoriteti Kontraktues mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni, për shkak të Mospërmbushjeve të Koncesionarit, të cilat nuk janë korrigjuar brenda një afati 3 (tre mujor), ose një afat tjetër të rënë dakord mes Palëve, apo kur Mospërmbushjet e Koncesionarit nuk mund të korrigojnë. Autoriteti Kontraktues nuk mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni në rastet kur ka zbatuar një sanksion, siç parashikohet nga neni 22, dhe sanksioni është shlyer rregullisht nga Koncesionari.
- 15.3.2 Në rastet e nenit 15.3.1 më sipër, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të njoftojë Koncesionarin dhe Palët Financuese, siç parashikohet në nenin 15.7.1 për qëllimin e tij për të zgjidhur kontratën, duke i dhënë një afat 90 (nentedhjetë) ditor. Nëse Palët Financuese, brenda këtij afati, nuk veprojnë në përputhje me

- të drejtat e tyre, atëherë Autoriteti Kontraktues do të njoftojë zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni, me efekt 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit të këtij njoftimi.
- 15.3.3 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, Koncesionari ka të drejtë për Kompensimin e parashikuar nga Aneksi 4a, pa cenuar këtu të drejtën e Autoritetit Kontraktues për të ekzekutuar Sigurimin e Kontratës.
- 15.3.4 Pas Datës së Zgjidhjes, për shkak të Mospërbushjeve të Koncesionarit, Koncesionari brenda nje afati 60 ditor, do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralin, në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 24.
- 15.4 Zgjidhja e njëanshme e Kontratës së Koncesionit nga Koncesionari, për shkak të Mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktues apo të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm
- 15.4.1 Koncesionari mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni për shkak të Mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktues të cilat nuk janë korrigjuar brenda një afati 3 (tre mujor), ose një afati tjetër të rënë dakord mes Palëve, apo kur Mospërbushjet e Autoritetit Kontraktues nuk mund të korrigjohen. Koncesionari mund të zgjidhë gjithashtu këtë Kontratë Koncesioni në rast të një Veprimi Shtetëror Thelbësisht të Dëmshëm, që nuk është korrigjuar sipas parashikimeve të nenit 14.3. Në këto raste, Koncesionari, do të ketë të drejtë të njoftojë zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni, me efekt 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit të këtij njoftimi.
- 15.4.2 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, për shkak të Mospërbushjeve të Autoritetit Kontraktues, apo për shkak të një Veprimi Thelbësisht të Dëmshëm, Koncesionari ka të drejtë të kompensohet, sipas parashikimeve të Aneksit 4b.
- 15.4.3 Pas shlyerjes së Kompensimit referuar më sipër, nga Autoriteti Kontraktues, atëherë Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralin, brenda nje afati 30 ditor në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 24.
- 15.5 Zgjidhja për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore
- 15.5.1 Secila nga Palët mund të zgjidhë këtë Kontratë Koncesioni në rast të një Ngjarje të Forcës Madhore, e cila zgjat për më shumë se afati i caktuar në nenin 14.2.2, dhe pasojat e të cilës nuk mund të rregullohen nga asnjëra Palë. Secila Palë do të njoftojë Palën tjetër mbi zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Koncesionit, me efekt të menjëhershëm
- 15.5.2 Autoriteti Kontraktues nuk ka të drejtë ta zgjidhë këtë Kontratë nëse Koncesionari riparon ose rregullon dëmet e shkaktuara si pasojë e një Ngjarje të Forcës Madhore.
- 15.5.3 Në rast të zgjidhjes së kësaj Kontrate Koncesioni sipas parashikimeve të mësipërme, Koncesionari ka të drejtë për Kompensimin e parashikuar nga Aneksi 4c.
- 15.5.4 Pas Datës së Zgjidhjes për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore, Koncesionari do t'i transferojë Autoritetit Kontraktues të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin mbi Hidrocentralin (për pjesën e realizuar, apo të mbetur, në vijim të një Ngjarje të Forcës Madhore), në përputhje me parashikimet e dorëzimit sipas nenit 24.
- 15.6 Zgjidhja e Kontratës me mirëkuptim



15.6.1 Palët kanë të drejtë ta zgjidhin këtë Kontratë Koncesioni me mirëkuptim. Me zgjidhjen e kësaj Kontrate Koncesioni sipas kësaj pike, Koncesionari ka të drejtë të kompensohet, në mënyrën dhe masën e rënë dakord nga negociata të ndërsjella, por në çdo rast kompensimi nuk do të jetë më i ulët se vlera e investimit.

## 15.7 Të Drejtat e Palëve Financuese dhe Zëvendësimi i Koncesionarit

### 15.7.1 Njoftimi i Palëve Financuese

Autoriteti Kontraktues, në rast të zgjidhjes së kësaj kontrate sipas nenit 15.3, përveç njoftimit të Koncesionarit, ka të drejtë të njoftojë edhe Palët Financuese me qëllim dhënien e një mundësie për të ndihmuar Koncesionarin në korrigjimin e Mospërmbushjes, ose në marrjen e masave për të rregulluar këto shkelje sikurse është rënë dakord, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

### 15.7.2 Zëvendësimi i Koncesionarit

- a) Në rast se pas ndihmës së ofruar nga Pala Financuese, nuk është bërë i mundur korrigjimi i shkeljes nga Koncesionari, Pala Financuese (nëse e gjykon me interes) zgjedh, të ndërhyjë duke i propozuar Autoritetit Kontraktues, transferimin e Projektit në duart e një ekipi menaxherial zëvendësues ose një subjekti zëvendësues i cili duhet që të ketë, ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën të barasvlershme me atë të Koncesionarit në momentin e fitimit të garës;
- b) Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues nuk do të pengojë apo vonojë pa arsye, pëlqimin e tij dhe do të bëjë ato veprime që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim të drejtash në lidhje me Palët Kontraktuese.
- c) Zëvendësuesi, do të ketë të drejtën e menaxhimit/administrimit të projektit dhe do të realizojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, por nuk do të ketë të drejtë të shesë, të transferojë, të vendosë barra siguroese mbi hidrocentralin.
- d) Nëse Pala Financuese vendos të mos ushtrojë të drejtat e parashikuara në këtë nen, ose nëse edhe pas ushtrimit të këtyre të drejtave nuk arrihet në një zgjidhje të arsyeshme për vazhdimësinë e projektit, kontrata do të zgjidhet.

## Neni 16 Kontratat

16.1 Koncesionari në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë të lidhë kontrata për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontratë tjetër, me qëllim realizimin e objektit të koncesionit. Në të gjitha kontratat, Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate Koncesioni si dhe legjislacionit në fuqi.

16.2 Koncesionari duhet të pajisë Autoritetin Kontraktues me informacionin e mëposhtëm për nën-kontraktuesin e propozuar:

- (a) Emrin e tij dhe adresën;
- (b) Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar;
- (c) Vlerën e nënkontratës dhe
- (d) Çdo informacion i mëtejshëm i kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.

- 16.3 Koncesionari është përgjegjës përpara Autoritetit Kontraktues, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.
- 16.4 Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Koncesionarit.

#### **Neni 17** **Sigurimi i Kontratës**

- 17.1 Përpara hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate Koncesioni, dhe si Kusht Paraprak i saj, Koncesionari duhet të ketë ngurtësuar për llogari të Autoritetit Kontraktues, pranë një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, të licencuar në Republikën e Shqipërisë, vlerën e Sigurimit të Kontratës e cila përfaqëson 5% të vlerës së investimit, pa përfshirë TVSH dhe vlerën e Aseteve Ekzistuese. Forma e sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet kësaj Kontrate Koncesioni si Aneksi 5.
- 17.2 Koncesionari ka të drejtë, që me kërkesë të tij, Autoriteti Kontraktues të lejojë ç'ngurtësimin e 80% (tetëdhjetë përqind) të vlerës së Sigurimit të Kontratës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e nënshkrimit të Certifikatës së Pranimit të veprës nga Autoriteti Kontraktues, testimit dhe vënies në punë të saj sipas parashikimeve të nenit 13. Pjesa e mbetur prej 20% (njëzet përqind) e vlerës së Sigurimit të Kontratës do të ç'ngurtësohet në përfundim të Periudhës së Koncesionit, në përputhje me nenin 4 të kësaj Kontrate Koncesioni. Sigurimi i Kontratës do të shërbejë për të garantuar zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar, të detyrimeve të Koncesionarit në lidhje me përfundimin e punimeve të ndërtimit, kryerjen e testimit dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera gjatë gjithë periudhës së kontratës së koncesionit.

#### **Neni 18** **Sigurimet**

- 18.1 Koncesionari në çdo kohë, do të pajiset, mbajë dhe ripërtërijë ato garanci sigurimi të kërkuara në lidhje me ushtrimin e të Drejtave Koncesionare dhe do t'i përcjellë, ose do të kujdeset që t'i përcillen Autoritetit Kontraktues kopjet e certifikuara të çdo certifikatë sigurimi pas marrjes së një njoftimi paraprak prej Autoritetit Kontraktues.
- 18.2 Koncesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të Impianteve dhe më pas Projektin e plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, të paktën nga rreziqet e parashikuara sipas Ligjit 52/2014 date 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda një afati 15 ditor nga data e sigurimit.
- 18.3 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë operimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi, sipas kontratave përkatëse të sigurimit, duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit. Pjesa e zbritshme nga shuma që siguruesi do të paguajë për kompensimin e dëmit do të përballohet nga koncesionari.
- 18.4 Koncesionari duhet të sigurojë nën përgjegjësinë e tij dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.

- 18.5 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjësie jo më të ulët se 200,000 Euro për çdo ngjarje dhe 500,000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jetë më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2,000 Euro në vit.
- 18.6 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

### **Neni 19 Tarifa Koncesionare**

- 19.1 Koncesionari do të paguajë për llogari të Autoritetit Kontraktues një tarifë koncesionare të barabartë me vlerën e 2.1% (dy pikë një përqind) të prodhimit vjetor të energjisë elektrike.
- 19.2 Tarifa e koncesionit do të paguhet në sasi energjie, duke filluar nga data e prodhimit dhe përllëqitur në prodhimin faktik të Hidrocentralit, të matur në Pikën e Lidhjes me Rrjetin Kombëtar të Energjisë. Me qëllim përllëquritjen e tarifës së koncesionit në kWh, Koncesionari do të përcaktojë momentet e referimit të niveleve të prodhimit të energjisë, bazuar mbi mesataren e prodhimit për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare, sipas një marrëveshje mes paleve.
- 19.3 Vlera përkatëse e sasisë së energjisë së pagueshme për Asetet Ekzistuese, do të kryhet duke u bazuar mbi vlerën përfundimtare të përcaktuar nga NJTDAE apo Eksperti i Pavarur, të ndarë në këste të barabarta, të pagueshme në çdo vit, duke filluar nga data e fillimit të prodhimit të energjisë, deri në fund të Periudhës së Koncesionit.
- 19.4 Mënyra e pagesës së tarifës së koncesionit dhe Vlera përkatëse e sasisë së energjisë së pagueshme për Asetet Ekzistuese do të përcaktohet në marrëveshje ndërmjet Palëve brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate Koncesionare.

### **Neni 20 Kufizimet**

- 20.1. Çdo Ortak i Shoqërisë Koncesionare gëzon të drejtën të transferojë lirisht një pjesë apo të gjithë pjesëmarrjen e tij brenda shoqërisë koncesionare, në çdo moment dhe pa nevojën e ndonjë miratimi nga Autoriteti Kontraktues.
- 20.2 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar tek palë të treta, Koncesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues. Në këtë rast palës së tretë do t'i transferohen dhe detyrimet apo të drejtat e përcaktuara në kontratën e koncesionit.
- 20.3. Koncesionari nuk ka të drejtë të nënkontrakttojë asnjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate, për vlera më të mëdha se 50 % të vlerës së investimit, pa marrë miratimin paraprak, me shkrim, të Autoritetit Kontraktues. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nënkontraktorë sipas kësaj Kontrate.
- 20.4. Koncesionari ka të drejtë të vendosë hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Koncesionarit në këtë Kontrate dhe vetëm me miratimin me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 21 Raportimi**

- 21.1 Koncesionari është i detyruar që çdo 3 (tre) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve financiare dhe në natyrë, dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

## **Neni 22 Sanksionet**

- 22.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate Koncesioni, penalizon Koncesionarin si më poshtë:
- (a) Koncesionari për çdo ditë vonese në fillimin e punimeve, përtej afatit të parashikuar nga neni 12.1. penalizohet me 5,000 lekë.
  - (b) Për shkelje të afatit të përfundimit të ndërtimit të objektit, parashikuar sipas programit të punimeve bashkëlidhur si Aneksi 3, Koncesionari penalizohet me 5,000 lekë për çdo ditë vonese.
  - (c) Në rast se fuqia e instaluar është më e vogël se 90% e kapacitetit të instaluar të planifikuar sipas kësaj Kontrate Koncesioni, Koncesionari do të penalizohet deri në 10% të të ardhurave të pritshme, që do të siguroheshin nga energjia elektrike e prodhuar nga kapaciteti i përealizuar (nën 90%).
- 22.2 Sanksionet paguhen në llogarinë e Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të diskutojnë për një periudhë 60 ditore lidhur me shkeljen.
- 22.3 Kur merret një vendim për zbatimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 60 ditëve nga data e dhënies së njoftimit. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë edhe kamatë vonesat ligjore, të përlogaritur sipas metodologjisë bazuar mbi mesataren e interesave të depozitave me afat 1 (një) vjeçar, të zbatuar përpjesëshmërisht për periudhën e vonesës, së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor.
- 22.4 Zbatimi dhe pagesa e penaliteteve sipas këtij neni nuk e çliron Koncesionarin nga përbushja e detyrimeve dhe parashikimeve të kësaj kontrate.
- 22.5 Këto penalitete, nëse nuk paguhen nga Koncesionari sipas afatit të përcaktuar më sipër, do të mbahen nga Sigurimi i Kontratës, parashikuar nga neni 17 i kësaj Kontrate Koncesioni. Për shmangien e çdo paqartësie apo keqkuptimi, totali i sanksioneve të mundshme të zbatuara nga Autoriteti Kontraktues sipas këtij neni, përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, nuk do të tejkalojë vlerën e sigurimit të kontratës.

## **Neni 23 Rregullimi i Shkeljeve**

- 23.1. Në rast se një Palë, gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, konstaton se Pala tjetër ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë e cila ka efekte negative thelbësisht të dëmshme për zbatimin e koncesionit, ajo menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Palës tjetër duke pritur për një periudhë 80 (tetëdhjetë) ditore përgjigjen e saj, me



argumentet përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkëlja.

- 23.2. Kjo procedurë nuk i zhvesh Palët nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mos përmbushja e detyrimeve.

#### **Neni 24 Transferimi i Aseteve/Dorëzimi**

- 24.1 Me mbarimin e kontratës, Konçesionari do të kryejë çdo veprim të nevojshëm për dorëzimin tek Autoriteti Kontraktues, të aseteve të marra në dorëzim nga ai, ato të realizuara nga Konçesionari gjatë periudhës së koncesionit si dhe çdo titull mbi to, të zhveshura nga çdo lloj detyrimi, barrë apo hipoteke. Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Koncesionit me një inspektim të përbashkët të Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.
- 24.2 Konçesionari, duhet të transferojë pa kundërshtëpërblim në favor të Autoritetit Kontraktues:
- a) hidrocentralin dhe objektet ekzistuese të lidhura me të;
  - b) ndërtesa, makineri, paisje;
  - c) pronësinë mbi ndërtesat apo impiantët e ndërtuara nga ai;
  - d) të drejtat kontraktore;
  - e) dorëzimin e librave, dokumentave dhe garancive që shoqërojnë këto asete;
  - f) çdo të drejtë tjetër të fituar nga ai nëpërmjet kësaj kontrate;
- 24.3 Konçesionari, duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune, duke marrë parasysh normën e amortizimit përkatës, me përjashtim të rasteve kur gjendja e tyre ka pësuar ndryshime të shkaktuara nga Forca Madhore.
- 24.4 Kostot e transferimit të projektit do të përballohen nga konçesionari, përveç rastit kur zgjidhja e kontratës ka ardhur si pasojë e Mospërmbushjes së Autoritetit Kontraktues ose Veprimit Thelbësisht të Dëmshëm. Forca Madhore përbën shkak për pezullimin e kontratës dhe nëse situata nuk zgjidhet gjatë periudhës së pezullimit, mund të vijohet me përfundimin e kontratës, në këto rast kostot e transferimit të projektit, do të përballohen nga të dy palët.
- 24.5 Në rast se pas përfundimit të Kohëzgjatjes së Koncesionit, Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet Publik tjetër, vendos të privatizojë Hidrocentralin, Palët pranojnë se Konçesionarit, në cilësinë e projektuesit të Hidrocentralit, do të ketë të drejtën parabletjes së tij në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 25 Përfundimi i Kontratës së Koncesionit**

- 25.1 Kontrata e Koncesionit përfundon me mbarimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh dispozitat e parashikuara nga neni 4 i kësaj Kontrate Koncesioni.
- 25.2 Përfundimi i kësaj Kontrate Koncesioni me mbarimin e afatit të saj ose në rast të zgjidhjes së parakohshme, nuk e çliron Konçesionarin nga detyrimi për të paguar detyrimet e prapambetura kundrejt Autoritetit Kontraktues dhe Palëve të Treta.

**Neni 26**  
**Konfidencialiteti**

- 26.1 Secila nga Palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, përfshirë dhe pa u kufizuar edhe në lidhje me palët financuese dhe nuk duhet t'ua bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e Palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

**Neni 27**  
**Ndryshimet**

- 27.1 Kjo Kontratë Koncesioni mund të ndryshohet, shtohet dhe/ose zëvendësohet vetëm me marrëveshje me shkrim të të dyja palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 27.2 Çdo ndryshim i kësaj Kontrate Koncesioni apo Anekseve bashkëlidhur saj do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj Kontrate.

**Neni 28**  
**Bashkëpunimi dhe Komunikimet midis Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit**

- 28.1 Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari zotohen të bashkëpunojnë për të garantuar realizimin e plotë të projektit.
- 28.2 Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet Palëve, do të kryhet vetëm me shkrim, në gjuhën shqipe apo në versionin shqip të përkthyer në anglisht, në adresat e treguara më poshtë, apo në adresat e përditësuara nga Palët nëpërmjet një njoftimi. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të secilës prej këtyre të dhënave, brenda një afati 20 (njetzet) ditor nga data e ndryshimit.
- 28.3 Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues kërkesë me shkrim, për çdo ndihmë që do t'i kërkohet këtij të fundit, në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.
- 28.4 Adresat dhe numrat e kontaktit që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate Koncesioni janë:

Për Autoritetin Kontraktues

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Blvd. Dëshmorët e Kombit, Nr. 1001,  
Tiranë – Shqipëri

Për Koncesionarin

Shoqëria Koncesionare "AYEN - ALB"  
S.H.A  
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.2,  
Rr. "Papa Gjon Pali i II-të", ABA  
Business Center, Kati 6,  
Tiranë - Shqipëri

**Neni 29**  
**Legjislacioni i Zbatueshëm**

29.1 Lidhja, zbatimi dhe interpretimi i kësaj Kontrate Koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar.

### **Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 30.1 Nëse do të lindë ndonjë mosmarrëveshje nga kjo Kontratë ose në lidhje me të ("Mosmarrëveshje"), secila nga Palët do t'i japë Palës tjetër njoftim në lidhje me këtë Mosmarrëveshje, pas së cilës Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari do të takohen menjëherë dhe do të përpiqen me mirëbesim të arrijnë një zgjidhje me pajtim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dhënia e njoftimit.
- 30.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me pajtim në përputhje me afatin dhe modalitetet e Nenit 30.1, mosmarrëveshjet e natyrës teknike apo ekonomike, do t'i paraqiten një Eksperti të Pavarur. Në rastet kur është i nevojshëm vendimi lidhur me një Mosmarrëveshje nga Eksperti i Pavarur, asnjëra nga Palët nuk do të ketë të drejtë t'ia paraqesë këtë mosmarrëveshje për gjykim arbitrazhit ndërkombëtar nëse kjo mosmarrëveshje nuk i është paraqitur së pari për marrjen e një vendimi Ekspertit të Pavarur.
- 30.3 Nëse njera Palë dëshiron të paraqesë apo dergojë çështjen para një Eksperti Teknik dhe Ekonomik do të njoftojë Palën tjetër për këtë qëllim dhe Palët do të takohen dhe përpiqen të bien dakord mbi personin që do të jetë Eksperti Teknik dhe Ekonomik. Nëse, brenda 20 ditëve nga data e dhënies së këtij njoftimi, Palët nuk kanë rënë dakord për emërimin, çështja do të paraqitet përpara Presidentit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, të cilit do t'i kërkohet të emërojë Ekspertin Teknik dhe Ekonomik brenda 30 ditëve. Kostot, shpenzimet dhe pagesat e Ekspertit Teknik dhe Ekonomik dhe këshilltarëve të tij, do të ngarkohen Palës Mospërmbushëse apo mund të ndahen përpjesëtimisht, sipas përcaktimit në vendimin e ekspertit, por në çdo rast do të parapaguhet nga Koncesionari.
- 30.4 Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin Mosmarrëveshjet sipas procedurave të mësipërme të këtij Neni, atëherë, secila Palë do të ketë të drejtë të kërkojë që Mosmarrëveshja t'i paraqitet për gjykim arbitrazhit ndërkombëtar të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris (ICC), siç parashikohet më poshtë.
- a) Nëse njera Palë dëshiron t'ia paraqesë një mosmarrëveshje arbitrazhit ndërkombëtar në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate, ajo duhet t'ia njoftojë këtë me shkrim Palës tjetër dhe mosmarrëveshja do të zgjidhet përfundimisht nga arbitrazhi ndërkombëtar në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.
  - b) Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga 3 (tre) arbitra, njëri prej të cilëve do të përzgjidhet nga Koncesionari, njëri nga Autoriteti Kontraktues, dhe i treti (i cili do të veprojë si Kryetar i trupit gjykues) do të përzgjidhet bashkërisht nga arbitrat e përzgjedhur nga Koncesionari dhe Autoriteti Kontraktues.
  - c) Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris, Francë.
  - d) Gjuha e procedurave të arbitrazhit do të jetë anglishtja.

### **Neni 31 Regjistrimi i Kontratës së Koncesionit**

31.1 Pas miratimit të projektit të zbatimit, Kontrata e Koncesionit duhet të regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

31.2. Kjo Kontratë Koncesioni u hartua në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe dhe 4 (katër) kopje në gjuhën angleze. Në rast mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të jetë detyrues për Palët.

Kjo Kontratë, pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noteri e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

## **PALËT**

**AUTORITETI KONTRAKTUES**  
**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**  
**Përfaqësuar nga:**

**Gentian Këri**  
**Sekretar i Përgjithshëm**

**KONCESIONARI**  
**Shoqëria Koncesionare "AYEN - ALB" Sh.A.**  
**Përfaqësuar nga:**

**Z. Fahrettin Amir ARMAN**  
**Administrator**